

EVANGELII NUNTIANDI

NXITJA APOSTOLIKE E ATIT TË SHENJTË PALI VI

Fort të nderuar Vëllezër dhe të dashur Bij e Bija, ju jap përshëndetjen time dhe Bekimin Apostolik.

HYRJE

ANGAZHIMI I VEÇANTË PËR UNGJILLËZIMIN

1. Angazhimi për t'ua shpallur Ungjillin njerëzve të kohës sonë, që janë të gjallëruar nga shpresa, por, njëkohësisht, shpesh të trazuar nga frika dhe ankthi, është pa asnjë dyshim një shërbim që i bëhet jo vetëm bashkësisë së krishterë, por edhe të gjithë njerëzimit. Prej këtu rrjedh detyra për t'i forcuar vëllezërit, që ne i kemi marrë prej Zotit me detyrën e Pasardhësit të Pjetrit (1), dhe që është për ne një “zekth i përditshëm” (2), një program i jetës e i veprimit dhe një detyrë themelore e pontifikatit tonë; kjo detyrë na duket edhe më fisnike dhe e domosdoshme atëherë kur bëhet fjalë për t'i inkurajuar vëllezërit tanë në misionin e ungjillëzuesve, në mënyrë që, në këto kohëra pasigurie dhe çrregullimi, ata ta kryejnë atë me dashuri, zell dhe gëzim gjithmonë e më të mëdhenj.

ME RASTIN E TRI NGJARJEVE

2. Është pikërisht ajo që ne duam të bëjmë këtu, në përfundimin e këtij Viti të Shenjtë, në rrjedhën e të cilit Kisha, “e prirë me çdo përpjekje kah predikimi i Ungjillit të gjithë njerëzve” (3), nuk ka dashur të bëjë tjetër përveçse ta kryejë detyrën e vet si lajmëtare e Lajmit të Mirë të Jezu Krishtit, detyrë kjo e shpallur falë dy urdhrave themelore: “Vishuni me njeriun e ri” (4) dhe “Pajtohuni me Hyjin” (5).

Duam ta bëjmë këtë gjë në këtë dhjetëvjetor të mbylljes së Koncilit II të Vatikanit, objektivat e të cilit përmbledhen, në fund të fundit, në një të vetëm: ta bëjmë Kishën e shek. XX gjithmonë e më të përshtatshme për t'ia shpallur Ungjillin njerëzimit të këtij shekulli.

Duam ta bëjmë një vit pas asamblesë së tretë të përgjithshme të Sinodit të Ipeshkvijve – që, siç dihet, i është kushtuar ungjillëzimit – e që për më tepër kjo na është kërkuar nga vetë Etërit e Sinodit. Në fakt, në fund të kësaj asambleje të paharrueshme, ata kanë vendosur që t'ia lënë Bariut të Kishës universale, me besim të madh dhe thjeshtësi, frytin e punës së tyre, duke deklaruar se pritin nga Papa një hov të ri të aftë për të krijuar, në një Kishë edhe më të rrënjosur në fuqinë dhe pushtetin e vazhdueshëm të Rrëshajëve, kohëra të reja ungjillëzimi (6).

TEMË E THEKSUAR SHPESH GJATË PONTIFIKATIT TONË

3. Për këtë temë të ungjillëzimit, ne e kemi theksuar shpeshherë rëndësinë e saj shumë kohë përpara kremtimit të Sinodit. “Kushtet e shoqërisë – thoshim në Kolegjin e Shenjtë të Kardinalëve, më 22 qershor të vitit 1973 – na detyrojnë të gjithëve që t'i rishikojmë metodat, të studiojmë çdo mënyrë se si t'ia çojmë njeriut të ditëve tona lajmin e krishterë, vetëm në të cilin ai mund të gjejë përgjigjen e pyetjeve të tij dhe fuqinë për angazhimin e tij të solidaritetit njerëzor” (7). Dhe ne shtojmë se për t'i dhënë një përgjigje të vlefshme kërkesave të Koncilit, që kërkojnë ndërhyrjen tonë, është absolutisht e nevojshme që t'i drejtohem pasurisë së fesë, që Kisha e ka për detyrë ta ruajë në pastërtinë e saj të paprekshme, por edhe t'ua paraqesë atë njerëzve të kohës sonë, për aq sa është e mundur, në mënyrë të kuptueshme dhe bindëse.

NË LINJËN E SINODIT TË VITIT 1974

4. Kjo besnikëri ndaj një lajmi, të cilit i jemi shërbëtorë, dhe ndaj njerëzve, të cilëve duhet t'ia transmetojmë atë të paprekur dhe të gjallë, është boshti qendror i ungjillëzimit. Ajo na vë përpara tri pyetje, që ngjallin shqetësim, të cilat Sinodi i vitit 1974 i ka pasur vazhdimisht para sysh.

- Çfarë bëhet sot me këtë energji të fshehur të Lajmit të Mirë, që është në gjendje ta godasë thellësisht ndërgjegjen e njeriut?

- Deri në çfarë pike dhe si është në gjendje kjo forcë ungjillore ta shndërrojë me të vërtetë njeriun e këtij shekulli?

- Cilat metoda duhet të ndiqen për shpalljen e Ungjillit, derisa fuqia e tij të mund të japë efekt?

Këto pyetje sqarojnë, në të vërtetë, pyetjen themelore që Kisha e bën sot dhe që mund të përkthehej kështu: pas Koncilit dhe falë tij, që ka qenë për të një orë e Hyjit në këtë pikë të historisë, a ndihet Kisha e përshtatshme për ta shpallur Ungjillin dhe për ta futur atë në zemrën e njeriut me bindje, liri të shpirtit dhe efektshmëri?

FTESË PËR REFLEKTIM

5. Ne të gjithë e shohim urgjencën për t'i dhënë kësaj pyetjeje një përgjigje besnike, të përvuajtur, të guximshme, dhe, si rrjedhojë, të veprojmë. Me "përkujdesjen tonë për të gjitha Kishat" (8), ne do të donim që t'i ndihmojmë vëllezërit dhe bijtë tanë për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve. Fjalët tona, që, duke u nisur nga pasuritë e Sinodit, do të donim të ishin një reflektim mbi ungjillëzimin, urojmë që ta ftojnë në të njëjtin reflektim të gjithë popullin e Hyjit, të bashkuar në Kishë, dhe t'i japin një hov të ri të gjithëve, veçanërisht "atyre që lodhen në fjalë dhe në mësim", derisa secili prej tyre të jetë "një besimtar shpërndarës i fjalës të së vërtetës" (10) dhe ta bëjë punën e predikuesit të Ungjillit, duke e përsosur mbarëshkrimin e vet. Një nxitje e tillë na është dukur e një rëndësie parësore, sepse paraqitja e lajmit ungjillor nuk është për Kishën diçka që zgjedh ta bëjë ose jo: është detyra që e ka marrë prej porosisë së Zotërisë Jezus, me qëllim që njerëzit të mund të besojnë dhe të shpëtohen. Po, ky lajm është i nevojshëm. Është i vetëm. Është i pazëvendësueshëm. Nuk duron as indiferencë, as sinkretizma, as kompromise. Këtu luhet me shpëtimin e njerëzve. Ai paraqet bukurinë e zbulimit. Përmban një urti që nuk është e kësaj bote. Është në gjendje të nxisë, vetvetiu, fenë, një fe që mbështetet në fuqinë e Hyjit (11). Ai është e Vërteta. E meriton që Apostulli t'ia kushtojë këtij Lajmi të gjithë kohën e vet, të gjitha energjitë e veta dhe që ta flijojë edhe jetën e vet, nëse është e nevojshme.

I. NGA KRISHTI UNGJILLËZUES TE KISHA UNGJILLËZUESE

DËSHMIA DHE MISIONI I JEZUSIT

6. Dëshmia që jep Zotëria për vetveten dhe që Shën Luka e ka mbledhur në Ungjillin e tij – “Më duhet ta shpall Ungjillin e Mbretërisë së Hyjit” (12) – pa dyshim që ka një rëndësi të madhe, sepse e përcakton me një fjalë misionin e Jezusit: “Për këtë jam dërguar” (13). Këto fjalë marrin të gjithë domethënien e tyre, nëse i referohen rreshtave pararendës, ku Krishti ia kishte veshur vetvetes shprehjen e Isaisë profet: *‘Shpirti i Zotit është mbi mua sepse Ai më shuguroi! Ai më dërgoi t’u kumtoj të vobektëve Ungjillin’* (14).

Ta shpallë qytet më qytet, mbi të gjitha më të varfërve, që shpesh janë më të hapur, lajmin e gëzueshëm të përmbushjes së premtimeve dhe të Besëlidhjes së premtuar prej Hyjit: i tillë është misioni për të cilin Jezusi e shpall veten të dërguar prej Atit. Dhe të gjitha aspektet e Mbarëshimit të tij - vetë Mishërimi, mrekullitë, mësimi, thirrja e dishepujve, dërgimi i të Dymbëdhjetëve, Kryqi dhe ngjallja, vazhdimësia e pranisë së tij në mesin e të tijve - janë përbërës të veprimtarisë së tij ungjillëzuese.

JEZUSI, UNGJILLËZUESI I PARË

7. Shumë shpesh, në rrjedhën e punimeve të Sinodit, Ipeshkvijtë e kanë kujtuar këtë të vërtetë: vetë Jezusi, Ungjilli i Hyjit (15), ka qenë absolutisht i pari dhe më i madhi ungjillëzues. Ka qenë deri në fund: deri në përsosmëri dhe deri në flijimin e jetës së tij tokësore.

Të ungjillëzosh: çfarë domethënieje ka pasur kjo domosdoshmëri për Krishtin? Sigurisht që nuk është e lehtë për t’i shprehur, në një përmbledhje të plotë, kuptimin, përmbajtjen, mënyrat e ungjillëzimit, ashtu siç i konceptoi dhe i kreu vetë Krishti. Nga ana tjetër, kjo përmbledhje nuk do të mund të përfundojë kurrë. Na mjafton që të kujtojmë disa aspekte thelbësore.

SHPALLJA E MBRETËRISË SË HYJIT

8. Si Ungjillëzues, Krishti shpall para së gjithash një Mbretëri, Mbretërinë e Hyjit, e cila është aq e rëndësishme për të, sa që gjithçka tjetër bëhet “ajo çka mbetet”, pra, është “ajo që na jepet si shtesë”. Vetëm Mbretëria, pra, është absolute dhe e bën relative çdo gjë tjetër. Zoti kënaqet duke përshkruar, në shumë forma të ndryshme, lumturinë e përkatësisë në këtë Mbretëri, lumturi paradoksale, e përbërë prej gjërave që bota i refuzon (17); kërkesat e Mbretërisë dhe Kushtetuta e saj (18), lajmëtarët e Mbretërisë (19), misteret e saj (20); të vegjlit e saj (21), vigjilenca dhe besnikëria, që i kërkohen kujtdo që e pret ardhjen e saj përfundimtare (22).

SHPALLJA E SHPËTIMIT ÇLIRUES

9. Si bërthama dhe qendra e Lajmit të Mirë, Krishti shpall shpëtimin, dhuratë e madhe e Hyjit, që jo vetëm se është çlirim nga gjithçka që e shtyp njeriun, por është mbi të gjitha çlirim prej mëkatit dhe prej të Keqit, në gëzimin e njohjes së Hyjit dhe të qenurit të njohur prej tij, në gëzimin e kundrimin dhe të braktisjes së vetvetes atij. E gjithë kjo fillon gjatë jetës së Krishtit, arrihet përfundimisht nëpërmjet vdekjes dhe ngjalljes, por duhet të çohet përpara me durim në rrjedhën e historisë, për t’u kryer plotësisht në ditën e ardhjes përfundimtare të Krishtit, të cilën askush nuk e di kur do të jetë, përveç Atit (23).

ME ÇMIMIN E NJË STËRMUNDIMI KRYQËZUES

10. Këtë Mbretëri dhe këtë shpëtim, - fjalë kyçe të ungjillëzimit të Jezu Krishtit - çdo njeri mund t’i marrë si hir dhe mëshirë, dhe jo më pak secili duhet që njëkohësisht t’i arrijë me forcë – u përkasin të fortëve,

thotë Zotëria (24) – me mund dhe vuajtje, me një jetë sipas Ungjillit, me vetëmohim dhe kryq, me shpirtin e lumturive. Por, para së gjithash, çdo njeri i fiton ato nëpërmjet një përmbysjeje të brendshme, të cilën Ungjilli e quan *metanoia*, një shndërrim i thellë i mendjes dhe i zemrës (25).

ME PREDIKIM TË PALODHSHËM

11. Këtë shpallje të Mbretërisë së Hyjit, Krishti e kryen nëpërmjet predikimit të palodhshëm të një fjale, e cila nuk mund të krahasohet me asnjë fjalë tjetër: “Ja një mësim i ri pajisur me pushtet!” (26); “Të gjithë dëshmonin dhe mrekulloheshin për fjalët e bukura që dilnin prej gojës së tij” (27); “Askurrë askush s’ka folur si ky njeri!” (28). Fjalët e tij zbulojnë fshehtësinë e Hyjit, planin dhe premtimin e tij, dhe e ndryshojnë kështu zemrën e njeriut dhe fatin e tij.

ME SHENJA UNGJILLORE

12. Por, ai e vë në jetë këtë shpallje përmes shenjave të shumta, që ngjallin habinë e turmave dhe, në të njëjtën kohë, i çojnë drejt tij për ta parë, për ta dëgjuar dhe për të lejuar që të shndërrohen prej tij. Pra, kemi të sëmurë që shërohen, ujë që kthehet në verë, bukë që shumohet, të vdekur që kthehen në jetë. E ndër të gjitha, kemi shenjën së cilës ai i jep një rëndësi të madhe: të vegjlit, të varfrit ungjillëzohen, bëhen nxënësit e tij, bashkohen “në emër të tij” në bashkësinë e madhe të atyre që besojnë në të. Sepse ai Jezus që thoshte: “Më duhet ta shpall Ungjillin e Mbretërisë së Hyjit” (29), është po ai Jezus për të cilin Gjoni ungjilltar thoshte se kishte ardhur dhe duhej të vdiste “për t’i mbledhur bijtë e Hyjit të shpërndarë” (30). Kështu, ai përmbush zbulimin, duke e plotësuar dhe duke e përforcuar me çdo dëftim që bën për vetveten, nëpërmjet fjalëve dhe veprave, shenjave dhe mrekullive, dhe në mënyrë më të veçantë me anë të vdekjes së tij, ngjalljes së tij dhe dërgimit të Shpirtit të së Vërtetës (31).

PËR NJË BASHKËSI TË UNGJILLËZUAR DHE UNGJILLËZUESE

13. Ata që e pranojnë me sinqeritet Lajmin e Mirë, pikërisht për virtyt të këtij pranimi dhe të fesë që merr pjesë në këtë pranim, bashkohen në emër të Jezusit për ta kërkuar së bashku Mbretërinë, që ta ndërtojnë e ta jetojnë atë. Urdhri i dhënë Apostujve – “dilni e predikoni Ungjillin” – vlen, edhe pse ndryshe, për të gjithë të krishterët. Është pikërisht kjo arsyeja që Pjetri i quan këta të fundit, “popull të cilin Hyji e fitoi për vete, për t’i shpallur veprat e tij të mrekullueshme” (32), të njëjtat mrekulli, të cilat çdo njeri ka mundur t’i dëgjojë në gjuhën e vet (33). Për më tepër, Lajmi i Mirë i Mbretërisë, që vjen dhe që ka filluar, është për të gjithë njerëzit e të gjitha kohërave. Ata që e kanë marrë dhe që ai i mbledh në bashkësinë e shpëtimit, mund dhe duhet ta shpallin dhe ta përhapin atë.

UNGJILLËZIMI, THIRRJE TIPIKE E KISHËS

14. Kisha e di. Ajo e ka një vetëdije të gjallë se fjala e Shpëtimtarit – “më duhet ta shpall Ungjillin e Mbretërisë” (34) - i mëvishet asaj në të gjithë të vërtetën e kësaj fjale. Dhe me dëshirë shton me Shën Palin: “Të shpall Ungjillin nuk është një arsye krenarie për mua, është detyrë që më duhet ta kryej: i mjeri unë nëse nuk e predikoj Ungjillin!” (35). Në përfundim të asamblesë së madhe të tetorit të vitit 1974, ne i kemi kuptuar me gëzim dhe ngushëllim këto fjalë të ndritshme: “Duam ta pohojmë sërish se porosia për t’i ungjillëzuar të gjithë njerëzit përbën misionin thelbësor të Kishës” (36), detyrë dhe mision që shndërrimet e mëdha dhe të thella të shoqërisë aktuale nuk i bëjnë më pak urgjente. Në fakt, ungjillëzimi është hiri dhe thirrja tipike e Kishës, identiteti i saj më i thellë. Kisha ekziston për të ungjillëzuar, vlen të themi për të predikuar dhe për të mësuar, për të qenë kanali i dhuratës së hirit, për t’i pajtuar mëkatarët me Hyjin, për ta

bërë të përhershme flinë e Krishtit në Meshën e shenjtë, që është përkujtimi i vdekjes së tij dhe i ngjalljes së tij të lavdishme.

LIDHJET E NDËRSJELLA MES KISHËS DHE UNGJILLËZIMIT

15. Kushdo që e rilexon zanafillën e Kishës në Besëlidhjen e Re, kur e ndjek hap pas hapi historinë e saj dhe kur e shqyrton mënyrën e jetesës dhe të veprimit të saj, vëren se ajo është e lidhur me ungjillëzimin si rrjedhojë e vetë natyrës së saj më të thellë:

- Kisha ka lindur prej veprimit ungjillëzues të Jezusit dhe të dymbëdhjetë Apostujve. Ajo është fryti normal, i dëshiruar, më i menjëhershëm dhe më i dukshëm: “Shkoni pra, bëni nxënës të mi të gjithë popujt” (37). Tani, “ata që e pranuan fjalën e tij, u pagëzuan e kështu, atë ditë, u kthyen rreth tri mijë vetë ... Vetë Zoti çdo ditë i shtonte bashkësisë nga ata që shpëtohen” (38).

- E lindur si rrjedhojë e misionit, Kisha, nga ana e vet, është e dërguar prej Jezusit. Kisha qëndron në botë, ndërsa Zoti i lavdisë kthehet tek Ati. Ajo mbetet si një shenjë njëherësh e zbehtë dhe e shndritshme e një praninë të re të Jezusit, e largimit dhe e qëndrimit të tij. Ajo e përhap dhe e vazhdon. Dhe, para së gjithash, Kisha është e thirrur që ta vazhdojë, pikërisht misionin dhe gjendjen e Jezusit si Ungjillëzues (39). Në fakt, bashkësia e të krishterëve nuk është kurrë e mbyllur në vetvete. Në të, jeta e brendshme – jeta e lutjes, dëgjimi i Fjalës dhe i mësimit të Apostujve, dashuria vëllazërore e jetuar, thyerja e bukës (40) – nuk e merr të gjithë domethënien e vet, përveçse kur ajo bëhet dëshmi, kur shkakton admirim dhe kthim, kur predikon dhe shpall Lajmin e Mirë. Kështu, e gjithë Kisha merr misionin për të ungjillëzuar dhe vepra e secilit është e rëndësishme për të gjithë.

- Si Ungjillëzuese, Kisha fillon me ungjillëzimin e vetvetes. Si bashkësi e besimtarëve, bashkësi ku shpresa jetohe dhe bashkëndahet, bashkësi e dashurisë vëllazërore, ajo ka nevojë që ta dëgjojë vazhdimisht atë që duhet ta besojë, arsyet e shpresës së saj, urdhrin e ri të dashurisë. Si popull i Hyjit i zhytur në bote, dhe shpesh i tunduar prej idhujve, Kisha ka gjithmonë nevojë që ta dëgjojë shpalljen e “veprave të mëdha të Hyjit” (41), që e kanë kthyer te Zoti dhe që të jetë sërish e thirrur dhe e mbledhur prej tij. Me një fjalë, kjo do të thotë se ajo ka gjithmonë nevojë që të ungjillëzohet, nëse do që ta ruajë freskinë, hovin dhe fuqinë për shpalljen e Ungjillit. Koncili II i Vatikanit e ka kujtuar këtë (42) dhe Sinodi i vitit 1974 e ka rimarrë fuqishëm këtë temë të Kishës që ungjillëzohet përmes një kthimi dhe një ripërtëritjeje të vazhdueshme, në mënyrë që ta ungjillëzojë me besueshmëri botën.

- Kishës i është besuar Lajmi i Mirë që duhet shpallur. Premtimet e Besëlidhjes së Re në Jezu Krishtin, mësimi i Zotërisë dhe i Apostujve, Fjala e jetës, burimet e hirit dhe të mirësisë së Hyjit, ecja e shpëtimit: të gjitha këto i janë besuar asaj. Përmbajtjen e Ungjillit, e kështu të ungjillëzimit, ajo e ruan si një depozitë të gjallë dhe të çmueshme, jo për ta mbajtur të fshehur, por për ta dhuruar.

- E dërguar dhe e ungjillëzuar, Kisha, nga ana e saj, dërgon ungjillëzues. Vë në gojën e tyre Fjalën që shpëton, u shpjegon atyre lajmin, të cilin ajo vetë e depoziton, u jep atyre porosinë që ajo vetë ka marrë dhe i dërgon që të predikojnë: por jo që ta predikojnë vetveten ose idetë e tyre personale (43), por Ungjillin. As ata, as Kisha nuk mund ta përdorin Ungjillin sipas qejfit, sepse ata nuk janë zotëruesit e pronarët e tij, por janë mbarështues për ta transmetuar atë me besnikëri shumë të lartë.

KISHA, E PANDASHME PREJ KRISHTIT

16. Ekziston, pra, një lidhje e thellë mes Krishtit, Kishës dhe ungjillëzimit. Gjatë kësaj kohe të Kishës, është ajo që e ka porosinë për të ungjillëzuar. Kjo porosi nuk përmbushet dot pa të, e as, për më tepër, kundër saj. Është mirë të theksohet në një moment si ky, kur ndodh të dëgjojmë, jo pa dhimbje, njerëz, që duam të besojmë se janë qëllimmirë, por sigurisht të çorientuar në shpirtin e tyre, që përsërisin se dëshirojnë ta duan Krishtin, por jo Kishën, ta dëgjojnë Krishtin, por jo Kishën, t'i përkasin Krishtit, por jashtë Kishës. Absurditeti i kësaj dikotomie duket qartazi në këto fjalë të Ungjillit: “Kush ju përbuz juve, më përbuz mua”

(44). E si mund të dëshirohet që të duhet Krishti pa e dashur Kishën, nëse dëshmia më e bukur që i bëhet Krishtit është ajo e Shën Palit: “Krishti e ka dashur Kishën dhe e ka flijuar vetveten për të”? (45)

II. ÇFARË DO TË THOTË UNGJILLËZIM

KOMPLEKSITETI I VEPRIMIT UNGJILLËZUES

17. Në veprimin ungjillëzues të Kishës, ka sigurisht elemente dhe aspekte për t'u vlerësuar. Disa janë aq të rëndësishëm saqë ka prirje të identifikohen thjesht me ungjillëzimin. Kështu, shpallja e Krishtit atyre që nuk e njohin, predikimi, katekeza, dhënia pagëzimit dhe sakramenteve të tjera ka arritur të quhet ungjillëzim. Asnjë përcaktim i pjesshëm dhe i copëzuar nuk mund të japë arsye për realitetin e pasur, kompleks dhe dinamik, siç është ai i ungjillëzimit, pa rënë në rrezikun e varfërimit e deri edhe të ndryshimit të tij. Është e pamundur ta kuptojmë, nëse nuk i marrim parasysh të gjithë elementët thelbësorë. Këta elementë, të theksuar qartë gjatë Sinodit të përmendur, thellohen ende, në këto kohëra, nën ndikimin e punimeve sinodale. Shprehim kënaqësinë tonë që ato po vendosen, parimisht, në linjën e atyre elementëve që na i ka transmetuar Koncili II i Vatikanit, sidomos në Kushtetutat "Lumen gentium", "Gaudium et spes" dhe në Dekretin "Ad gentes".

RIPËRTËRITJA E NJERËZIMIT...

18. Ungjillëzimi, për Kishën, është çuarja e Lajmit të Mirë në të gjitha shtresat e njerëzimit, dhe, me ndikimin e tij, ta shndërron atë nga brenda dhe ta bëjë të ri vetë njerëzimin: "Ja unë i bëj të reja të gjitha gjërat" (46). Por, nuk mund të ketë njerëzim të ri, nëse më parë nuk ka njerëz të rinj, prej risisë së pagëzimit (47) dhe të jetës sipas Ungjillit (48). Qëllimi i ungjillëzimit është pikërisht ky ndryshim i brendshëm dhe, nëse është e nevojshme të thuhet me një fjalë, më e drejtë do të ishte që të thuhej se Kisha ungjillëzon atëherë kur, vetëm falë fuqisë hyjnore të Mesazhit që ajo shpall (49), kërkon ta kthejë ndërgjegjen personale dhe kolektive të njerëzve, veprimtarinë në të cilën angazhohen, jetën dhe mjedisin e tyre konkret.

...DHE E SHTRESAVE TË NJERËZIMIT

19. Shtresa të njerëzimit që shndërrohen: për Kishën, nuk bëhet fjalë vetëm që ta predikojë Ungjillin në terrene gjeografike gjithmonë e më të gjera ose te popullsitë gjithnjë e më të shtrira, por edhe që të arrijë t'i prekë dhe pothuajse t'i përmbysë, me anë të fuqisë së Ungjillit, kriteret e gjykimit, vlerat përcaktuese, pikat e interesit, vijat e mendimit, burimet frymëzuese dhe modelet e jetës së njerëzimit, që janë në kundërshtim me Fjalën e Hyjit dhe me planin e shpëtimit.

UNGJILLËZIMI I KULTURAVE

20. E gjithë kjo do të mund të shprehej në këtë mënyrë: duhet ungjillëzuar – jo në mënyrë zbukuruese, si një lustër sipërfaqësore, por në mënyrë jetësore, në thellësi dhe deri në rrënjë – kultura dhe kulturat e njeriut, në kuptimin e pasur dhe të gjerë që kanë këto terma në Kushtetutën *Gaudium et spes* (50), duke u nisur gjithmonë nga personi dhe duke u kthyer gjithnjë te marrëdhëniet e njerëzve mes tyre dhe me Hyjin. Ungjilli, e për rrjedhojë ungjillëzimi, sigurisht që nuk identifikohen me kulturën dhe janë të pavarur nga të gjitha kulturat. Megjithatë, Mbretëria, që e shpall Ungjilli, jetohet nga njerëz që janë thellësisht të lidhur me një kulturë dhe ndërtimi i Mbretërisë nuk mund të mos përfitojë nga elementet e kulturës dhe të kulturave njerëzore. Të pavarur përballë kulturave, Ungjilli dhe ungjillëzimi nuk janë medoemos të papajtueshëm me to, por janë në gjendje që t'i ngopin të gjitha, pa iu nënshtruar asnjërës. Ndërprerja e marrëdhënieve mes Ungjillit dhe kulturës është pa dyshim drama e epokës sonë, sikurse që edhe për epokë të tjera. Duhet pra, të bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme për një ungjillëzim bujar të kulturës, më saktë të kulturave. Ato duhet të ripërtërihen përmes takimit me Lajmin e Mirë. Por, ky takim nuk do të ndodhë, nëse nuk shpallet Lajmi i Mirë.

RËNDËSIA PARËSORE E DËSHMISË SË JETËS

21. Kjo shpallje, pra, duhet që para së gjithash të bëhet me anë të dëshmisë. Ja: një i krishterë apo një grup të krishterësh, në gjirin e bashkësisë së njerëzve ku jetojnë, shfaqin aftësi kuptimi dhe pranimi, njësim të jetës dhe të fatit me të tjerët, solidaritet në përpjekjet e të gjithëve për gjithçka që është fisnike dhe e mirë. Ja: në mënyrë shumë të thjeshtë dhe spontane, ata e rrezatojnë fenë në disa vlera që i tejkalojnë vlerat e kohës, dhe shpresën në diçka që nuk shihet dhe që nuk do të guxohej të merrej me mend. Atëherë, me një dëshmi të tillë pa fjalë, këta të krishterë ngjallin në zemrat e atyre që i shohin tek jetojnë pyetje të parezistueshme: Përse janë kështu? Përse jetojnë në një mënyrë të tillë? Çfarë apo kush i frymëzon? Përse janë në mesin tonë? E, po, një dëshmi e tillë është tashmë një shpallje e heshtur, por shumë e fortë dhe e efektshme e Lajmit të Mirë. Kemi këtu një gjest fillestar të ungjillëzimit. Ndoshta të tilla pyetje do të jenë të parat që do të bëjnë shumë jo të krishterë, qofshin ata njerëz të cilëve Krishti nuk u ishte shpallur kurrë më parë, të pagëzuar jo praktikues, individë që jetojnë në krishterim, por sipas parimeve aspak të krishtera, ose njerëz që kërkojnë, jo pa vuajtje, diçka ose Dikë që ata e parandiejnë pa mundur që t'i japin një emër. Pyetje të tjera do të lindin, më të thella e më angazhuese; të shkaktuara nga kjo dëshmi që kërkon prani, pjesëmarrje, solidaritet dhe që është një element thelbësor në ungjillëzim, në përgjithësi i pari (51). Të gjithë të krishterët janë të thirrur për këtë dëshmi dhe në këtë drejtim të gjithë mund të jenë ungjillëzues të vërtetë. Të mendojmë para së gjithash për përgjegjësinë që kanë emigrantët në vendet ku ata shkojnë.

DOMOSDOSHMERIA E NJË SHPALLJEJE TË HAPUR

22. Megjithatë, edhe kjo shpallje mbetet gjithmonë e pamjaftueshme, sepse edhe dëshmia më e bukur do të rezultojë e pafuqishme për shumë kohë, nëse na mungon shndritja, arsyeja - atë që Shën Pjetri e quante “të japësh përgjigje për arsyen e shpresës që është në ju” (52) - dhe qartësia për ta shpallur hapur Jezusin Zot. Kështu, Lajmi i Mirë, i shpallur nga dëshmia e jetës, herët a vonë do të duhet të shpallet nga fjala e jetës. Nuk ka ungjillëzim të vërtetë, nëse nuk shpallen emri, mësimi, jeta, premtimet, Mbretëria dhe misteri i Jezusit të Nazaretit, Birit të Hyjit.

Historia e Kishës, duke filluar që nga predikimi i Pjetrit në mëngjesin e Rrëshajëve, përzihet dhe shkrihet me historinë e kësaj shpalljeje. Në çdo etapë të re të historisë njerëzore, Kisha, vazhdimisht në ankth nga dëshira për të ungjillëzuar, nuk ka veçse një shqetësim: kë të dërgojë për ta shpallur misterin e Jezusit? Me çfarë gjuhe ta shpallë këtë mister? Si mund të sigurohet se ai do të dëgjohet dhe do të mbërrijë te të gjithë ata që duhet ta dëgjojnë? Kjo shpallje – kerygmë, predikim apo katekezë – zë një vend të atillë në ungjillëzim, saqë shpesh është bërë sinonim i ungjillëzimit. Megjithatë, ajo nuk është tjetër veçse një aspekt i tij.

PËR NJË NDJEKJE TË GJALLË DHE BASHKËSIORË

23. Në fakt, shpallja nuk është e plotë, përveçse atëherë kur kuptohet, pranohet, përvetësohet dhe kur arrin të ngjallë në atë që e ka marrë shpalljen një ndjekje me zemër. Ndjekje e të vërtetave që Zoti na i ka zbuluar për mëshirë të vet. Por, edhe më shumë, është një ndjekje e programit të jetës – jetë tashmë e shndërruar – që e propozon kjo shpallje. Me një fjalë, është ndjekje e Mbretërisë, d.m.th. e “botës së re”, e gjendjes së re të gjërave, e mënyrës së re të të qenurit, të të jetuarit dhe të të jetuarit së bashku, të cilën e përuan Ungjilli. Një ndjekje e tillë, që nuk mund të mbesë abstrakte dhe e pamishëruar, zbulohet konkretisht me anë të një hyrjeje të dukshme në bashkësinë e besimtarëve. Kështu, pra, ata, jeta e të cilëve është shndërruar, futen në një bashkësi që është në vetvete shenjë e shndërrimit dhe e risisë së jetës: është Kisha, sakramenti i dukshëm i shpëtimit (53). Por, në të njëjtën kohë, hyrja në bashkësinë kishtarë do të shprehet përmes shumë shenjave të tjera, të cilat e shtrijnë dhe e shpalosin shenjë e Kishës. Në dinamizmin e ungjillëzimit, ai që e pranon

Ungjillin si Fjalë që shpëton (54), e përkthen normalisht në këto gjeste sakramentore: futje në Kishë, marrje e sakramenteve, të cilat e dëftojnë dhe e mbështesin këtë futje me anë të hirit që japin.

BËN QË TË LINDË NJË APOSTULLIM I RI

24. Më në fund, kush është ungjillëzuar bëhet edhe ai vetë ungjillëzues. Këtu është prova e së vërtetës, shkëmbi i krahasimit të ungjillëzimit: është e pamendueshme që një njeri ta ketë pranuar Fjalën e t'i jetë dhënë Mbretërisë, pa u bërë njëkohësisht një njeri që dëshmon dhe shpall. Në përfundim të këtyre vërejtjeve mbi kuptimin e ungjillëzimit, na takon ta japim edhe një sugjerim të fundit, të cilin e çmojmë shndritës për reflektimet që vijojnë.

Kemi thënë se ungjillëzimi është një proces kompleks dhe me elemente të ndryshme: ripërtëritje e njerëzimit, dëshmi, shpallje e hapur, pranim nga zemra, hyrje në bashkësi, marrje e shenjave dhe nisma apostullimi.

Këto elemente mund të duken se janë në kundërshtim me njëri-tjetrin e deri edhe përjashtuese. Por, në të vërtetë, ata janë bashkëplotësuese dhe e pasurojnë njëri-tjetrin në mënyrë të ndërsjellë. Gjithmonë duhet që secili prej tyre të shihet në marrëdhënie me të tjerët.

Merita e Sinodit të fundit qëndron në faktin se ai na ka ftuar vazhdimisht që t'i vëmë bashkë këto elemente, në vend se t'i vëmë kundër njëri-tjetrit, me qëllim që ta marrim kuptimin e plotë të veprimtarisë ungjillëzuese të Kishës.

Është kjo pamja universale, që duam ta paraqesim tani për shqyrtimin e përmbajtjes së ungjillëzimit, për shqyrtimin e mjeteve për ungjillëzim dhe për të saktësuar se kujt i drejtohet shpallja ungjillore dhe se kush e ka sot këtë detyrë.

III. PËRMBAJTJA E UNGJILLËZIMIT

PËRMBAJTJA THELBËSORE DHE ELEMENTET DYTËSORE

25. Sigurisht që ka shumë elemente dytësore në mesazhin që shpall Kisha. Paraqitja e tyre varet shumë prej rrethanave që ndryshojnë. E gjithashtu edhe ato ndryshojnë. Mirëpo, është përmbajtja thelbësore, substanca e gjallë, që nuk mund të modifikohet e as të kalohet në heshtje, pa e çnatyralizuar rëndë vetë ungjillëzimin.

DËSHMIA QË I BËHET DASHURISË SË ATIT

26. Nuk është e tepërt të kujtojmë se ungjillëzimi është para së gjithash të dëshmosh, në mënyrë të thjeshtë e të drejtpërdrejtë, Hyjin e zbuluar nga Jezu Krishti, në Shpirtin Shenjt; të dëshmosh që Hyji e ka dashur botën në Birin e tij; që në Fjalën e tij të mishëruar i ka dhënë ekzistencën çdo gjëje dhe i ka thirrur njerëzit në jetën e pasosur. Ky dëftim i Hyjit do të bëjë ndoshta që t'u mbërrijë shumë njerëzve Hyji i panjohur (55), të cilin ata e adhurojnë pa i dhënë një emër, ose që e kërkojnë përmes një frymëzimi të fshehtë të zemrës atëherë kur e përjetojnë zbrazëtinë e të gjithë idhujve. Por, është plotësisht ungjillëzuese kur me këtë dëftim kuptojmë se, për njeriun, Krijuesi nuk është një fuqi anonime dhe e largët: është Ati. “Quhemi bijtë e Hyjit, edhe jemi me të vërtetë!” (56) e jemi, pra, vëllezër njëri me tjetrin në Hyjin.

NË QENDËR TË MESAZHIT: SHPËTIMI NË JEZU KRISHTIN

27. Ungjillëzimi do të përmbajë gjithmonë – si bazë, qendër dhe njëherësh kulm i dinamizmit të tij – edhe një shpallje të qartë se, në Jezu Krishtin, Birin e Hyjit të bërë njeri, të vdekur dhe të ngjallur, shpëtimi i është ofruar çdo njeriu, si dhuratë e hirit dhe e mëshirës së vetë Hyjit (57). E jo një shpëtim imanent, në përmasën e nevojave materiale ose edhe shpirtërore, që shterojnë në kuadrin e ekzistencës tokësore dhe që identifikohen tërësisht me dëshirat, shpresat, angazhimet, luftërat e përkohshme, por në të vërtetë një shpëtim që i tejkalon të gjithë këta kufij për t'u vënë në bashkim me të vetmen “Absolute”, atë të Hyjit: shpëtimin transhendent, eskatologjik, që e ka, sigurisht, fillimin e tij në këtë jetë, por që përmbushet në amshim.

NËN SHENJËN E SHPRESËS

28. Për rrjedhojë, ungjillëzimi, nuk mund të mos e përmbajë shpalljen profetike të një realiteti të përtejme, thirrje e thellë dhe përfundimtare e njeriut, në vazhdimësi dhe njëherësh në pavazhdimësi me situatën e tanishme: përtej kohës dhe historisë, përtej realitetit të kësaj bote, trajta e së cilës kalon, dhe përtej gjërave të kësaj bote, shpallje për të cilën një ditë do të shfaqet një përmasë e fshehur; madje edhe përtej vetë njeriut, fati i vërtetë i të cilit nuk përfundon në aspektin e tij të përkohshëm, por do të zbulohet në jetën e ardhshme (58).

Ungjillëzimi përmban, pra, edhe predikimin e shpresës në premtimet që Hyji i ka dhënë në Besëlidhjen e Re në Jezu Krishtin; predikimin e dashurisë së Hyjit ndaj nesh dhe të dashurisë sonë ndaj Hyjit; predikimin e dashurisë vëllazërore për të gjithë njerëzit – aftësi e dhurimit dhe e faljes, e vetëmohimit, e ndihmës ndaj vëllezërve e motrave – që, duke rrjedhur nga dashuria e Hyjit, është bërthama e Ungjillit; predikimin e misterit të së keqes dhe të kërkimit aktiv të së mirës.

Përmban gjithashtu edhe predikimin – dhe ky është gjithmonë urgjent – e kërkimit të vetë Hyjit me anë të lutjes, kryesisht asaj të adhurimit dhe të mirënjohjes, por edhe me anë të bashkimit me atë shenjë të dukshme të takimit me Hyjin që është Kisha e Jezu Krishtit. Ky bashkim shprehet në të njëjtën kohë nëpërmjet realizimit të atyre shenjave të tjera të Krishtit, të gjallë dhe veprues në Kishë, që janë Sakramentet. Të jetuarit e Sakramenteve në një mënyrë të tillë, që e çon kremtimin e tyre në një plotësim të vërtetë, nuk do

të thotë, siç do të pretendonte ndokush, që t'i vësh pengesë apo të pranosh një shmangie të ungjillëzimit, por, përkundrazi, t'i japësh atij përkryerjen vet. Sepse, ungjillëzimi, në tërësinë e tij, përveçse në predikimin e një mesazhi, qëndron edhe në mbjelljen e Kishës, e cila nuk ekziston pa këtë frymëmarrje, që është jeta sakramentore, e cila e arrin kulmin në Eukaristi (59).

MESAZH QË E PËRFSHIN TË GJITHË JETËN

29. Gjithashtu është e vërtetë se ungjillëzimi nuk do të ishte i plotë, nëse nuk do ta merrte parasysh thirrjen e ndërsjellë e të vazhdueshme mes Ungjillit dhe jetës konkrete, personale dhe shoqërore, të njeriut. Për këtë arsye, ungjillëzimi përmban në vetvete një mesazh të qartë, që u përshtatet situatave të ndryshme, vazhdimisht të aktualizuar, për të drejtat dhe detyrat e çdo personi njerëzor, për jetën familjare, pa të cilën rritja personale vështirë se bëhet e mundur (60), për jetën e përbashkët në shoqëri, për jetën mes kombeve, paqen, drejtësinë, zhvillimin; ky është një mesazh për çlirimin e njeriut, veçanërisht i fuqishëm në ditët tona.

NJË MESAZH ÇLIRUES

30. Dihet tashmë se me çfarë termash kanë folur, në Sinodin e fundit, Ipeshkvij të shumtë nga të gjitha kontinentet, sidomos Ipeshkvijtë e Botës së Tretë, me një theks baritor në të cilin jehonte zëri i miliona bijve të Kishës, që i formojnë ata popuj. Ne e dimë se janë popuj të angazhuar, me të gjitha energjitë e tyre, në mundime e në luftë për të tejkaluar gjithçka që i dënon të mbesin të lënë pas dore: mungesa e bukës, sëmundjet kronike, analfabetizmi, përnxitja ideologjike e varfërisë, padrejtësia në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe veçanërisht në shkëmbimet tregtare, situatat e kolonializmit të ri ekonomik dhe kulturor, shpeshherë po aq mizor sa edhe kolonializmi i vjetër politik. Kisha, kanë ritheksuar Ipeshkvijtë, e ka detyrën që t'ua shpallë çlirimin miliona qenieve njerëzore, duke qenë shumë prej tyre bijtë e saj; e ka detyrën që ta ndihmojë këtë çlirim të lindë, të dëshmojë për të, të veprojë në mënyrë të atillë që ky çlirim të jetë i plotë. E gjitha kjo nuk del jashtë ungjillëzimit.

NË LIDHJE TË DOMOSDOSHME ME PËRNXITJEN NJERËZORE

31. Në fakt, ekzistojnë ndërlidhje të thella mes ungjillëzimit dhe përnxitjes njerëzore, d.m.th. zhvillimit dhe çlirimit. Ato janë lidhje të rendit antropologjik, sepse njeriu që duhet ungjillëzuar nuk është diçka abstrakte, por një person i kushtëzuar prej çështjeve shoqërore dhe ekonomike; lidhje të rendit teologjik, sepse nuk mund të shkëputet plani i krijimit nga ai i Shëlbimit, që arrin deri në situatat shumë konkrete të luftës kundër padrejtësisë dhe vendosjes së drejtësisë; lidhje edhe të rendit tejet të spikatur ungjillor, siç është ai i dashurisë. Pra, si mund ta shpallim urdhrin e ri pa e përnxitur në drejtësi dhe në paqe rritjen e vërtetë të njeriut?

Ne kemi dashur ta theksojmë këtë duke sjellë në vëmendje se është e pamundur të pranojmë që «në ungjillëzim mund apo duhet të anashkalohej rëndësia e problemeve, kaq të diskutuara sot, që lidhen me drejtësinë, çlirimin, zhvillimin dhe paqen në botë. Kjo do të thoshte të harrojmë mësimin që na jep Ungjilli mbi dashurinë për të afërmin e vuajtur dhe nevojtar» (61). Tashti, të njëjtët zëra që e kanë përballuar me zell, mençuri dhe guxim këtë temë kyçe gjatë punimeve të Sinodit të përmendur, kanë ofruar, me gëzimin tonë të madh, parimet shndritëse për të kuptuar rëndësinë dhe kuptimin e thellë të çlirimit, të cilin e ka shpallur dhe kryer Jezusi i Nazaretit, e të cilin e predikon Kisha.

PA ZVOGËLIME E PA DYKUPTIMËSI

32. Në fakt, nuk duhet ta fshehim që shumë të krishterë, edhe pse bujarë e të ndjeshëm ndaj çështjeve dramatike që përmbledh në vetvete problemi i çlirimit, duke dashur ta angazhojnë Kishën në përpjekjet për

arritjen e tij, e kanë shpesh tundimin që ta zvogëlojnë misionin e saj në përmasat e një projekti thjesht tokësor; detyrat e saj në një plan antropologjik; shpëtimin, për të cilin Kisha është lajmëtare dhe sakrament, në një mirëqenie materiale; dhe veprimtarinë e saj, duke anashkaluar çdo shqetësim shpirtëror dhe fetar, në nisma të nivelit politik dhe shoqëror. Por, po të ishte kështu, Kisha do ta humbte kuptimin e vet themelor. Mesazhi i saj i çlirimit nuk do të kishte më asnjë origjinalitet dhe do të zaptuhej dhe manipulohet lehtësisht nga sistemet ideologjike dhe partitë politike. Ajo nuk do të kishte më autoritet ta shpallte çlirimin si shpallje nga ana e Hyjit. Për këtë arsye, ne kemi dashur ta theksojmë, në përkim me fjalimin e mbajtur në fillim të Asamblesë së tretë Sinodale, «domosdoshmërinë e ripohimit të qartë të qëllimit posaçërisht fetar të ungjillëzimit. Ungjillëzimi do ta humbte arsyen e ekzistencës së vet, nëse do të largohej qoftë edhe për pak nga boshti fetar drejtues, që është Mbretëria e Hyjit para çdo gjëje tjetër, në kuptimin e vet plotësisht teologjik» (62).

ÇLIRIMI UNGJILLOR

33. Rreth çlirimit, që ungjillëzimi shpall dhe mundohet të kryejë, mbi të gjitha, duhet të thuhet se:

- ai nuk mund të kufizohet në kuptimin e thjeshtë e të ngushtë ekonomik, politik, shoqëror ose kulturor, por duhet të synojë njeriun në tërësi, në çdo përmasë të tij, bashkë me hapjen e tij ndaj absolutes, edhe ndaj Absolutes së Hyjit;

- është i rrënjësor, pra, në një lloj botëkuptimi të njeriut, në një antropologji, që nuk mundet kurrë të flijohet për kërkesat e një strategjie çfarëdo, një praktike apo një efektshmërie afatshkurtër.

I THEMELUAR NË MBRETËRINË E HYJIT

34. Prandaj, me predikimin e çlirimit dhe duke u bashkuar me ata që veprojnë dhe vuajnë për të, Kisha - pa lejuar që ta kufizojë misionin e saj vetëm në fushën fetare, duke mos treguar interes për problemet konkrete të njeriut – ripohon parësinë e thirrjes së saj shpirtërore, refuzon ta zëvendësojë shpalljen e Mbretërisë me shpalljen e çlirimeve njerëzore dhe pohon se edhe ndihmesa e saj për çlirim nuk është e plotë, nëse lë pas dore shpalljen e shpëtimit në Jezu Krishtin.

NË NJË KËNDVËSHTRIM UNGJILLOR TË NJERIUT

35. Kisha e lidh çlirimin njerëzor me shpëtimin në Jezu Krishtin, por kurrë nuk i identifikon me njëra-tjetrën, sepse ajo e di prej zbulesës, prej përvojës historike dhe prej reflektimit të fesë se jo çdo nocion i çlirimit medoemos qëndron dhe përputhet me këndvështrimin ungjillor të njeriut, të gjërave dhe të ngjarjeve; ajo e di edhe se nuk mjafton ardhja e çlirimit, krijimi i mirëqenies dhe zhvillimi që të vijë Mbretëria e Hyjit. Shumë më tepër, Kisha e ka bindjen e fortë se çdo çlirim tokësor, çdo çlirim politik – edhe nëse përpiqet ta gjejë arsyetimin e vet në këtë apo në atë faqe të Besëlidhjes së Vjetër apo të Re, edhe nëse pretendon, për postulatet e tij ideologjike dhe për normat e tij të veprimit, autoritetin e të dhënave dhe të përfundimeve teologjike, edhe nëse pretendon të jetë teologjia për ditët tona – mbart në vetvete farën e mohimit të vet dhe bie prej idealit që ai vetë propozon. Dhe kjo ndodh qoftë sepse motivet e tij nuk janë ato të drejtësisë në dashuri, qoftë sepse hovi që e shtyn nuk ka një përmasë me të vërtetë shpirtërore, si edhe sepse qëllimi i tij përfundimtar nuk është shpëtimi dhe lumturia në Hyjin.

KËRKON NJË KTHIM TË DOMOSDOSHËM

36. Sigurisht që Kisha e vlerëson të rëndësishëm dhe urgjent ndërtimin e strukturave më njerëzore, më të drejta, më respektuese ndaj të drejtave të njeriut, më pak shtypëse dhe më pak skllavëruese. Megjithatë, ajo është e vetëdijshme se strukturat më të mira dhe sistemet më së miri të idealizuara bëhen shumë shpejt

çnjerezore, nëse nuk shërohen prirjet çnjerezore të zemrës së njeriut e nëse nuk ndodh një kthim i zemrës dhe i mendjes së atyre që jetojnë në këto struktura dhe i zotërojnë ato.

E PËRJASHTON DHUNËN

37. Kisha nuk mund ta pranojë dhunën, sidomos forcën e armëve – që është e pakontrollueshme kur shpërthen – as vdekjen e askujt si rrugë çlirimi, sepse ajo e di se dhuna sjell gjithmonë dhunë dhe prodhon në mënyrë të pashmangshme forma të reja të shtypjes dhe të skllavërisë më të rënda se ato që ajo pretendonte të çlironte. E thamë qartë edhe në udhëtimin tonë në Kolumbi: «Ne ju ftojmë që të mos e vendosni besimin tuaj në dhunë, as në revolucion; një qëndrim i tillë është në kundërshtim me shpirtin e krishterë e mund edhe ta vonojë e të mos e favorizojë rritjen shoqërore për të cilën me të drejtë aspironi» (63); «duhet ta themi e ta ripohojmë se dhuna nuk është as e krishterë, as ungjillore dhe se ndryshimet e përnjëhershme e të dhunshme të strukturave do të ishin të rreme, jo të efektshme në vetvete dhe sigurisht jo në përputhje me dinjitetin e popullit» (64).

NDIHMESA E VEÇANTË E KISHËS

38. Pas këtyre që thamë më lart, ne jemi të gëzuar që Kisha ta fitojë një vetëdije gjithnjë e më të gjallë për mënyrën e vet, thelbësisht ungjillore, të bashkëpunimit për çlirimin e njerëzve. E çfarë bën? Ajo kërkon gjithmonë e më shumë që të nxisë një numër sa më të madh të krishterësh që t'i përkushtohen çlirimit të të tjerëve. U ofron këtyre të krishterëve «çlirimtarë» një frymëzim feje, një motivim të dashurisë vëllazërore, një mësim shoqëror përballë të cilit i krishteri i vërtetë nuk mund të jetë i pavëmendshëm, por që duhet ta vendosë në themel të urtisë së vet, të përvojës së vet, për ta kthyer atë pastaj konkretisht në veprim, pjesëmarrje dhe angazhim. Hovi i të krishterit të angazhuar duhet të karakterizohet nga e gjithë kjo, pa u ngatërruar me qëndrimet taktike e as me shërbimin e një sistemi politik. Kisha angazhohet për ta futur gjithmonë luftën e krishterë për çlirim në planin universal të shpëtimit që ajo vetë e shpall. Ajo që ne e kemi kujtuar këtu del më shumë se një herë nga debatet e Sinodit. Megjithatë, ne kemi dashur t'i kushtojmë kësaj teme disa fjalë sqarimi në Fjalimin e drejtuar Etërve në mbyllje të Asamblesë (65). Të gjitha këto konsiderata, duhet të shpresojmë, që të ndihmojnë për shmangien e dykuptimësisë që merr shumë shpesh fjala «çlirim» në ideologjitë, në sistemet apo në grupet politike. Çlirimi që shpall dhe përgatit ungjillëzimi është ai që vetë Krishti shpesh ia ka shpallur dhe ia ka dhuruar njeriut me anë të flisë së tij.

LIRIA FETARE

39. Nga ky çlirim i vërtetë që lidhet me ungjillëzimin, i cili synon fitimin e strukturave që sigurojnë mbrojtjen e lirive njerëzore, nuk mund të ndahet garantimi i të gjitha të drejtave themelore të njeriut, ndër të cilat liria fetare zë një vend të një rëndësie parësore. Kemi folur së fundmi për aktualitetin e kësaj çështjeje, duke theksuar se «sa të krishterë, ende sot, për faktin se janë të krishterë, sepse janë katolikë, jetojnë të shtypur nga një përndjekje e vazhdueshme! Drama e besnikërisë ndaj Krishtit dhe e lirisë së fesë, edhe pse e maskuar nga deklarata të drejtpërdrejta në përkrahje të të drejtave të njeriut dhe të shoqërisë njerëzore, vazhdon ende!» (66).

IV. RRUGËT E UNGJILLËZIMIT

NË KËRKIM TË MJETEVE TË PËRSHTATSHME

40. Rëndësia e dukshme e përmbajtjes së ungjillëzimit nuk duhet ta fshehë rëndësinë e rrugëve dhe mjeteve të ungjillëzimit.

Ky problem i metodës se «si të ungjillëzohet» mbetet gjithmonë aktual, sepse mënyrat ndryshojnë sipas rrethanave të kohës, vendit, kulturës, e kështu na vënë përpara njëfarë sfide që të tregojmë se sa jemi të aftë t'i zbulojmë dhe t'i përshtatim ato.

Veçanërisht neve, Barinjve të Kishës, na takon kujdesi për të rikrijuar me guxim dhe urti, në besnikëri të plotë me përmbajtjen e ungjillëzimit, mënyrat më të përshtatshme dhe më frytdhënëse për t'ia përçuar mesazhin ungjillor njerëzve të kohës sonë. Në këtë reflektim, mjafton të kujtojmë disa rrugë që, për një arsye apo për një tjetër, kanë një rëndësi themelore.

DËSHMIA E JETËS

41. Mbi të gjitha, pa përsëritur ato çfarë kemi thënë më lart, është mirë të theksohet kjo: për Kishën, dëshmia e një jete me të vërtetë të krishterë, e braktisur në Hyjin në një bashkim që nuk duhet ndërprerë nga asgjë, por njëkohësisht e dhuruar ndaj të afërmit me një zell të pakufishëm, është mjete i parë i ungjillëzimit. «Njeriu bashkëkohor dëgjon me më shumë endje dëshmitarët sesa mësuesit, - iu thoshim vitin e shkuar një grupi laikësh - ose nëse i dëgjon, e bën për faktin sepse janë dëshmitarë» (67). Shën Pjetri e shprehte mirë këtë kur përshkruante bukurinë e një jete të pastër dhe të respektueshme që «i fiton pa nevojën e fjalëve ata që refuzojnë t'i besojnë Fjalës» (68). Pra, është para së gjithash nëpërmjet sjelljes dhe jetës së saj që Kisha do ta ungjillëzojë botën, ia vlen të thuhet nëpërmjet dëshmisë së saj të jetuar me besnikëri ndaj Zotërisë Jezus, në varfëri, e shkëputur dhe e lirë prej pushteteve të kësaj bote, me një fjalë, në shenjtëri.

NJË PREDIKIM I GJALLË

42. Nuk është kot të theksohet, ndër të tjera, rëndësia dhe nevoja e predikimit. «E si do të besojnë në Atë, për të cilin nuk dëgjuan? Si do të dëgjojnë, nëse ndokush nuk ua predikon? ... Kështu, pra, besimi vjen nga predikimi, e predikimi është shpallja e Fjalës së Zotit» (69). Ky ligj i shpallur një ditë nga Pali Apostull e ruan ende sot të gjithë forcën e vet.

Po, predikimi është gjithmonë i domosdoshëm, kjo shpallje me fjalë e një mesazhi. E dimë mirë se njeriu modern, i ngopur me diskutime, shpesh duket i lodhur për të dëgjuar e, më keq ende, i imunizuar kundër fjalës. I dimë edhe idetë e psikologëve dhe sociologëve të shumtë, të cilët pohojnë se njeriu modern e ka tejkaluar qytetërimin e fjalës, tashmë e pafrytshme dhe e padobishme, dhe sot jeton në qytetërimin e imazhit. Sigurisht që këto fakte do të duhej të na shtynin që, për transmetimin e mesazhit ungjillor, të vëmë në veprim mjetet moderne të zbuluara nga ky qytetërim. Mirëpo, tashmë janë kryer përpjekje shumë të vlefshme në këtë drejtim. Ne nuk mund të bëjmë gjë tjetër veçse t'i lavdërojmë dhe t'i nxisim që të zhvillohen gjithnjë e më shumë. Megjithatë, lodhja që shkaktojnë sot shumë diskutime të kota dhe aktualiteti i shumë formave të tjera të komunikimit nuk duhet ta zvogëlojnë forcën e përhershme të fjalës, as të na bëjnë ta humbim besimin në të. Fjala mbetet gjithmonë aktuale, mbi të gjitha kur është përçuese e fuqisë së Hyjit (70). Për këtë mbetet ende aktual pohimi i Shën Palit: «Besimi vjen nga predikimi» (71): është pikërisht Fjala e dëgjuar që çon në besim.

LITURGJIA E FJALËS

43. Ky predikim ungjillëzues merr forma të shumta, të cilat zelli do t'i frymëzojë për të rikrijuar thuajse në pafundësi. Faktikisht, janë të panumërta ngjarjet e jetës dhe situatat njerëzore që ofrojnë rastin për një shpallje të matur, por të fuqishme dhe dinamike, të asaj që Zoti ka për të thënë në këtë rrethanë. Mjafton një ndjeshmëri e vërtetë shpirtërore që të dimë ta lexojmë mesazhin e Hyjit në ngjarjet që na rrethojnë. Por, që nga çasti në të cilin liturgjia e ripërtëritë nga Koncili e ka vlerësuar shumë «Liturgjinë e Fjalës», do të ishte gabim po të mos e shihnim homelinë si një instrument të vlefshëm dhe shumë të përshtatshëm ungjillëzimi. Sigurisht se nevojitet që ta njohim dhe të përfitojmë prej kërkesave dhe mundësive të homelisë, në mënyrë që ajo ta arrijë të gjithë efektshmërinë e vet baritore. Por, mbi të gjitha, nevojitet që të jemi të bindur dhe t'i përkushtohemi asaj me dashuri. Ky predikim, i futur në mënyrë të posaçme në kremtimin eukaristik, prej të cilit merr fuqi dhe pushtet të veçantë, sigurisht që ka një rol të çmuar në ungjillëzim, në masën në të cilën e shpreh fenë e thellë të mbarështuesit të shenjtë që predikon, dhe është i mbushur me dashuri. Besimtarët e bashkuar për të formuar një Kishë pashkvore, e cila kremton festën e Zotërisë të pranishëm në mesin e tyre, presin shumë prej këtij predikimi dhe nxjerrin fryt prej tij kur ky i fundit të jetë i thjeshtë, i qartë, i drejtpërdrejtë, i përshtatshëm, thellësisht i rrënjësor në mësimin ungjillor dhe besnik ndaj Magjisterit të Kishës, i gjallëruar nga një zell apostolik i ekuilibruar që vjen nga vetë karakteri i tij, plot me shpresë, ushqyes për fenë, krijues i paqes dhe i njësisë. Shumë bashkësi famullitare, ose të ndonjë lloji tjetër, jetojnë dhe përforcohen falë homelisë së çdo të diele, kur ajo i ka cilësitë e lartpërmendura. Shtojmë se, falë kësaj ripërtëritjeje liturgjike, kremtimi eukaristik nuk është i vetmi çast i përshtatshëm për homelinë. Kjo e gjen vendin e vet - dhe nuk duhet të anashkalohet - në kremtimin e të gjitha Sakramenteve, ose edhe gjatë kremtimeve të tjera, në mjedisin e asambleve të besimtarëve. Ky do të jetë gjithmonë një rast i privilegjuar për ta shpallur Fjalën e Zotit.

KATEKEZA

44. Njëra prej rrugëve që nuk duhet anashkaluar në ungjillëzim është ajo e mësimin katekistik. Inteligjenca, mbi të gjitha ajo e fëmijëve dhe e adoleshentëve, ka nevojë të mësojë, nëpërmjet një mësimi sistematik të besimit, të dhënat themelore, përmbajtjen e gjallë të së vërtetës që Hyji ka dashur të na transmetojë dhe që Kisha ka kërkuar ta shprehë në mënyrë gjithnjë e më të pasur në rrjedhën e historisë së saj të gjatë. Askush nuk do ta kundërshtojë faktin që ky mësim duhet të jepet për të formuar zakone të jetës së krishterë dhe jo për të mbetur vetëm në nivel intelektual. Sigurisht, përpjekja e ungjillëzimit do të nxjerrë një përfitim të madh, në planin e mësimin katekistik të dhënë në kishë, në shkolla (aty ku është e mundur), në çdo rast në familjet e krishtera, nëse katekistët zotërojnë tekste të përshtatshme, të përditësuara me urti dhe kompetencë, nën autoritetin e Ipeshkvijve. Metodat duhet t'i përshtaten moshës, kulturës, aftësisë së njerëzve, në kërkimin e vazhdueshëm për t'i ngulitur në kujtesë, në inteligjencë dhe në zemër të vërtetat thelbësore që do të duhet ta mbushin krejt jetën. Mbi të gjitha, nevojitet të përgatiten katekistë të mirë – katekistë të famullisë, mësues, prindër – të angazhuar për t'u përsosur në këtë art sipëror, të domosdoshëm e kërkuar për mësimin e besimit. Nga ana tjetër, pa neglizhuar në asnjë mënyrë formimin e fëmijëve, vërejmë se kushtet aktuale e bëjnë gjithnjë e më urgjent mësimin katekistik, në formën e një katekumenati, për shumë të rinj dhe të rritur, që, të prekur prej hirit, e zbulojnë pak nga pak fytyrën e Krishtit dhe e ndjejnë nevojën për t'iu dhuruar atij.

PËRDORIMI I «MEDIAVE»

45. Në shekullin tonë, i karakterizuar nga mediat apo instrumentet e komunikimit shoqëror, shpallja e parë, katekeza ose thellimi i mëtejshëm i fesë, siç e kemi theksuar tashmë, nuk mund të bëjë pa këto mjete. Të vëna në shërbim të Ungjillit, ato janë në gjendje ta shtrijnë pothuajse në pafundësi fushën e dëgjimit të Fjalës së Hyjit dhe bëjnë që Lajmi i Mirë t'u mbërrijë miliona njerëzve. Kisha do të ndihej në faj para Zotit të saj, nëse nuk do t'i përdorte këto mjete të fuqishme, të cilat inteligjenca njerëzore i bën çdo ditë e më të

përsosura. Duke u shërbyer me to, Kisha e predikon «prej pullazeve» (72) mesazhin, të cilin ajo e ruan. Në këto mjete, Kisha gjen një variant modern dhe të efektshëm të ambonit. Falë tyre, ajo arrin t'u flasë turmave. Megjithatë, përdorimi i instrumenteve të komunikimit shoqëror për ungjillëzim paraqet një sfidë: mesazhi ungjillor do të duhej që, nëpërmjet tyre, të arrinte te turmat e njerëzve, por me aftësinë për të depërtuar në ndërgjegjen e secilit, për t'u vënë në zemrën e secilit njeri, sikur ky të ishte i vetmi, me gjithçka që ai ka më të veçantë dhe personale, e t'ia arrijë që ta bëjë këtë njeri që ta pranojë Fjalën dhe të përgjigjet me një angazhim krejt personal.

KONTAKTI I DOMOSDOSHËM PERSONAL

46. Prandaj, përkrah shpalljes së bërë në formën e përgjithshme të Ungjillit, forma tjetër e përçimit të tij, nga një njeri në tjetrin, mbetet gjithmonë e vlefshme dhe e rëndësishme. Zotëria e ka zbatuar shpesh herë këtë gjë – siç dëshmojnë p.sh. bashkëbisedimet me Nikodemin, Zakeun, Samaritanen, Simonin farise e me të tjerë – e pas tij edhe Apostujt. Tek e fundit, a ekziston ndonjë formë tjetër për ta paraqitur Ungjillin sesa ajo e transmetimit të përvojës personale te të tjerët? Të mos lejojmë që urgjenca për t'ua shpallur Lajmin e Mirë turmave të njerëzve të na bëjë ta harrojmë këtë formë shpalljeje, përmes së cilës mbërrijmë ndërgjegjen personale të një njeriu, e cila preket prej një fjale krejtësisht të jashtëzakonshme që ai e merr nga një njeri tjetër. Ne nuk do të mund t'i lavdëronim mjaftueshëm ata meshtarë që, përmes Sakramentit të Rrëfimit ose përmes dialogut baritor, tregohen të gatshëm për t'i drejtuar njerëzit në rrugët e Ungjillit, për t'i forcuar në përpjekjet e tyre, për t'i ringritur, nëse kanë rënë, dhe për t'i ndihmuar gjithmonë me shqyrtim dhe gatishmëri.

ROLI I SAKRAMENTEVE

47. Për më tepër, nuk do të mund të theksohet kurrë mjaftueshëm fakti që ungjillëzimi nuk kufizohet vetëm në predikimin dhe mësimin e një doktrine. Ai duhet të arrijë jetën: jetën natyrore, së cilës i jep një kuptim të ri, falë perspektivave ungjillore që ia hap asaj; dhe jetën mbinatyore, që nuk është mohimi i jetës natyrore, por pastrimi dhe lartësimi i saj. Kjo jetë mbinatyore e gjen shprehjen e saj të gjallë në shtatë Sakramentet dhe në shkëlqimin e tyre të admirueshëm të hirit dhe të shenjtërisë. Ungjillëzimi e shpërndan kështu të gjithë pasurinë e vet kur realizon lidhjen më intime e, më mirë ende, një ndërkomunikim të pandërprerë mes Fjalës dhe Sakramenteve. Në njëfarë mënyre, është një keqkuptim të kundërvihen, siç bëhet shpeshherë, ungjillëzimi dhe sakramentalizimi. Është e vërtetë se dhënia e Sakramenteve, pa një bazë të fortë katekeze rreth tyre dhe një katekeze të përgjithshme, do t'ua zvogëlonte atyre për së tepërmi efektshmërinë. Detyra e ungjillëzimit është saktësisht ajo që të edukojë në fe në mënyrë të atillë që ta çojë çdo të krishterë në jetimin e Sakramenteve si Sakramente të vërteta feje dhe të mos i marrë ato në mënyrë pasive.

PËRSHPIRTËRIA POPULLORE

48. Këtu ne prekim një aspekt të ungjillëzimit që nuk mund të na lërë të pandjeshëm ndaj tij. Duam të flasim për atë realitet që shpesh sot emërtohet me termin fetari popullor. Qoftë në ato rajone ku Kisha është e themeluar prej shekujsh, qoftë atje ku ajo është në themelimin e sipër, gjenden në popull shprehje të veçanta të kërkimit të Hyjit dhe të fesë. Për një kohë të gjatë pak të vlerësuara, e nganjëherë edhe të përçmuara, këto shprehje sot përbëjnë gjithkund një objekt rizbulimi. Ipeshkvijtë e kanë thelluar kuptimin e këtyre shprehjeve, në zhvillimin e Sinodit të fundit, me një realizëm baritor dhe një zell të shkëlqyeshëm. Sigurisht, mund të thuhet se fetaria popullore i ka kufizimet e veta. Shumë shpesh, ajo është e hapur përballë depërtimit të shumë deformimeve të besimit, madje edhe të besëtytnive. Shpesh, ajo mbetet në nivelin e shfaqjeve të kultit të jashtëm, pa u angazhuar në një pranim të vërtetë feje. Kjo mund të çojë edhe në formimin e sekteve dhe ta vendosë në rrezik bashkësinë e vërtetë kishtarë.

Megjithatë, nëse është e orientuar mirë, mbi të gjitha përmes një pedagogjie ungjillëzimi, fetaria popullore është e pasur me vlera. Ajo shfaq një etje për Hyjin, që vetëm të thjeshtët dhe të varfrit mund ta njohin; i bën të aftë për bujari dhe flijim deri në heroizëm, kur bëhet fjalë për ta treguar fenë; sjell një kuptim të mprehtë të attributeve të thella të Hyjit: atësinë, provaninë, praninë e dashur dhe të vazhdueshme; prodhon qëndrime të brendshme, të cilat rrallë mund të vrojtohen diku tjetër në këtë nivel: duresë, kuptim të kryqit në jetën e përditshme, shkëputje, hapje ndaj të tjerëve, devocion. Për arsye të këtyre aspekteve, ne e quajmë me qëllim «përshpirtëri popullore», d.m.th. besim i popullit, më shumë sesa fetari.

Dashuria baritore duhet t'u sugjerojë të gjithë atyre, që Zoti i ka vënë si udhëheqës të bashkësive kishtare, normat e sjelljes përballë këtij realiteti kaq të pasur dhe njëherësh kaq delikat. Para së gjithash, duhet të jemi të ndjeshëm, të dimë t'i pranojmë përmasat e tij të brendshme dhe vlerat e tij të pamohueshme, të jemi të gatshëm për ta ndihmuar që t'i kapërcejë rreziqet e veta të devijimit. E orientuar mirë, kjo fetaria popullore mund të jetë gjithmonë e më tepër, për masat tona popullore, një takim i vërtetë me Hyjin në Jezu Krishtin.

V. TË ADRESUARIT E UNGJILLËZIMIT

NJË ADRESIM UNIVERSAL

49. Fjalët e fundit të Jezusit në Ungjillin e Markut i japin ungjillëzimit, për të cilin Zotëria i ngarkon me detyrë Apostujt, një universalizëm pa kufij: «Dilni në mbarë botën e predikoni Ungjillin të gjithë njerëzve» (73).

Të Dymbëdhjetët dhe breznia e parë e krishterë e kanë kuptuar shumë mirë mësimin e këtij teksti dhe të të tjerëve si ky; e kanë bërë atë një program veprimi. Madje, edhe vetë përndjekja, duke i shpërndarë Apostujt, i ka ndihmuar përhapjes së Fjalës dhe themelimit të Kishës në vende gjithmonë e më të largëta. Pranimi i Palit në radhët e Apostujve dhe karizma e tij si predikues i ardhjes së Jezu Krishtit ndër paganë – jo judenj - e ka theksuar edhe më tej këtë universalizëm.

PAVARËSISHT TË GJITHA PENGESAVE

50. Gjatë njëzet shekujve histori, breznitë e krishtera, kohë pas kohe, janë përballur me pengesa të ndryshme, që i kundërviheshin këtij misioni universal. Nga njëra anë, ishte tundimi, nga vetë ungjillëzuesit, për ta kufizuar me pretekste të ndryshme fushën e tyre të veprimit misionar. Nga ana tjetër, ishin kundërshtimet, shpesh njerëzisht të pakapërcyeshme, prej atyre të cilëve iu drejtohej ungjillëzuesi. Përveç këtyre, ne duhet të konstatojmë me trishtim që vepra ungjillëzuese e Kishës është kundërshtuar fuqishëm, për të mos thënë se edhe është penguar, nga pushtetet publike. Ndodh, edhe në ditët tona, që kumtuesit e Fjalës së Hyjit të privohen nga të drejtat e tyre, të përndiqen, të kërcënohen dhe të vriten vetëm për faktin sepse predikojnë Jezu Krishtin dhe Ungjillin e tij. Por, ne kemi besim se, pavarësisht këtyre provave të dhimbshme, në fund të fundit, vepra e këtyre apostujve nuk do të mungojë në asnjë vend të botës.

Pavarësisht kundërshtimeve të tilla, Kisha e gjallëron gjithmonë frymëzimin e saj më të thellë, atë që i vjen drejtpërsëdrejti prej Mësuesit të saj: Të gjithë botës! Të gjitha krijesave! Deri në skajet e tokës! Këtë ajo e ka bërë sërish në Sinodin e fundit, si një thirrje që të mos burgoset shpallja ungjillore duke e kufizuar atë vetëm për një pjesë të njerëzimit, apo për një klasë njerëzish, apo vetëm për një lloj kulture. Shembuj të tjerë do të mund të zbulonin shumëçka.

SHPALLJA E PARË E FESË ATYRE QË JANË LARG

51. Zbulimi i Jezu Krishtit dhe i Ungjillit të tij atyre që nuk e njohin është, që prej mëngjesit të Rrëshajëve, programi themelor që Kisha e ka pranuar ashtu siç e ka marrë prej Themeluesit. E gjithë Besëlidhja e Re, dhe në mënyrë të veçantë Veprat e Apostujve, dëshmojnë një moment të privilegjuar dhe, në njëfarë kuptimi, shembullor për këtë përpjekje misionare, që do vihet re pastaj gjatë gjithë historisë së Kishës.

Këtë shpallje të parë të Jezu Krishtit, ajo e kryen me anë të një veprimtarie komplekse dhe të shumëllojshme, që shpeshherë emërohet si «para-ungjillëzim», por që, të themi të vërtetën, është tashmë ungjillëzim, edhe pse në shkallën e vet fillestare dhe ende jo të plotë. Një gamë pothuajse e pafund mjetesh, predikimi i hapur, sigurisht, por edhe arti, aspekti shkencor, kërkimi filozofik dhe referimi i ligjshëm ndaj ndjenjave të zemrës njerëzore mund të përdoren për këtë qëllim.

SHPALLJA E FESË BOTËS SË ÇKRISHTERUAR

52. Nëse kjo shpallje e parë iu drejtohet veçanërisht atyre që nuk e kanë kuptuar kurrë Lajmin e Mirë të Jezusit ose fëmijëve, ajo rezulton barabar gjithnjë e më e nevojshme, për shkak të situatave të shpeshta të çkrishterimit në ditët tona, për një mori njerëzish që e kanë marrë pagëzimin, por që jetojnë krejtësisht jashtë jetës së krishterë, për njerëzit e thjeshtë që kanë njëfarë feje, por që kanë një njohje shumë të dobët të

themeleve të saj, për intelektualët që e ndjejnë nevojën ta njohin Jezu Krishtin në një dritë të ndryshme prej mësimit të marrë në fëmijërinë e tyre dhe për shumë të tjerë.

BESIMET JO TË KRISHTERA

53. Lajmi i Mirë iu drejtohet edhe pjesëve të mëdha të njerëzimit që praktikojnë besime jo të krishtera, të cilat Kisha i respekton dhe i vlerëson, sepse janë shprehje e gjallë e shpirtit të grupeve të gjera njerëzore. Ato mbartin në vetvete jehonën e kërimit disamijëvjeçar të Hyjit, kërkim jo i plotë, por i realizuar shpesh me sinqeritet dhe pastërti të zemrës. Zotërojnë një pasuri të mahnitshme tekstesh thellësisht fetare. Kanë mësuar breznitë të tëra njerëzish që të lutën. Të gjitha kanë në vetvete shumë «farëra të Fjalës» (74) dhe mund të jenë një «parapërgatitje për pranimin e Ungjillit» për të rimarrë një shprehje të gëzueshme të Koncilit II të Vatikanit, të cilën ky i fundit e merr nga Eusebi i Cesaresë.

Sigurisht që një situatë e tillë ngjall çështje komplekse dhe delikate, të cilat është mirë që të studiohen në dritën e Traditës së krishterë dhe të Magjisterit të Kishës për t'iu ofruar misionarëve të sotëm dhe të ardhshëm horizonte të reja në kontaktet e tyre me besimet jo të krishtera. Duam që ta theksojmë, sidomos sot, se as respekti dhe vlerësimi ndaj këtyre besimeve, e as kompleksiteti i problemeve të ngritura, nuk janë për Kishën një ftesë për ta lënë në heshtje shpalljen e Krishtit përpara jo të krishterëve. Përkundrazi, Kisha mendon se këto grupe njerëzish kanë të drejtën që ta njohin pasurinë e misterit të Krishtit (76), në të cilin ne besojmë se i gjithë njerëzimi mund të gjejë, në një plotësi të padyshueshme, gjithçka që ai me mundim kërkon të dijë mbi Hyjin, mbi njeriun dhe mbi fatin e tij, mbi jetën dhe mbi vdekjen, si dhe mbi të vërtetën. Edhe përballë shprehjeve fetare natyrore më të denja për respekt, Kisha bazohet, pra, mbi faktin se feja e Jezusit, që ajo e shpall me anë të ungjillëzimit, e vë njeriun objektivist në marrëdhënie me planin e Hyjit, me praninë e tij të gjallë, me veprimin e tij; ajo bën që të takohet kështu misteri i Atësisë hyjnore që përkulet mbi njerëzimin; me fjalë të tjera, besimi ynë vendos në mënyrë të efektshme një marrëdhënie të vërtetë dhe të gjallë me Hyjin, që besimet e tjera nuk arrijnë ta vendosin, edhe pse ato, le të themi, i shtrijnë duart e tyre drejt qiellit.

Prandaj, Kisha e mban të gjallë hovin e saj misionar dhe dëshiron gjithashtu që ta intensifikojë atë në momentin tonë historik. Ajo ndihet përgjegjëse përballë popujve të tërë dhe nuk gjen pushim derisa të mos ketë bërë më të mirën për ta shpallur Lajmin e Mirë të Jezusit Shpëtimtar. Ajo përgatit gjithmonë breza të rinj apostujsh. Këtë e pohojmë me gëzim në një kohë në të cilën nuk mungojnë ata që mendojnë dhe madje edhe thonë se zelli dhe hovi apostolik kanë shteruar dhe se epoka e Misioneve ka përfunduar tashmë. Sinodi është përgjigjur se shpallja misionare nuk thahet dhe se Kisha do të jetë gjithmonë e prirur kah përmbushja e kësaj shpalljeje.

MBËSHTETJA E FESË SË BESIMTARËVE

54. Megjithatë, Kisha nuk ndihet e përjashtuar nga një vëmendje gjithashtu e palodhshme ndaj atyre që e kanë marrë fenë dhe që shpesh, prej breznish, janë në kontakt me Ungjillin. Kështu, ajo kërkon ta thellojë, ta forcojë, ta ushqejë dhe ta bëjë gjithnjë e më të pjekur fenë e atyre që tashmë e quajnë veten besimtarë, në mënyrë që të jenë plotësisht të tillë.

Kjo fe, sot, është pothuajse gjithmonë e vënë përballë shekullarizimit, madje përballë ateizmit militant: është një fe e kërcënuar dhe e vënë përballë provave. Edhe më tepër, është një fe e sulmuar dhe e luftuar. Ajo rrezikon të humbasë për shkak të asfiksionit apo të dobësisë, nëse nuk mbahet dhe ushqehet vazhdimisht. Të ungjillëzosh, do të thotë, pra, shumë shpesh, t'i japësh fesë së besimtarëve – veçanërisht përmes një katekeze plot limfë ungjillore dhe të pajisur me një gjuhë të përshtatshme për kohërat dhe njerëzit – këtë mbështetje dhe ushqim të nevojshëm.

Kisha Katolike ka njësoj një përkujdesje të gjallë edhe për të krishterët që nuk janë në bashkim të plotë me të: ndërsa përgatit me ta njësimin e dëshiruar prej Krishtit dhe saktësisht për ta realizuar këtë njësim në të

vërtetën, ajo është e vetëdijshme se do ta linte në mënyrë të rëndë pa e kryer detyrën e saj, nëse nuk do t'ua dëshmonte atyre plotësinë e zbulimit, përmbajtjen e të cilit ajo e ruan.

JO BESIMTARËT

55. Domethënës është edhe shqetësimi, i shfaqur në Sinodin në fjalë, përse i përket dy sferave shumë të ndryshme njëra nga tjetra, e megjithatë shumë të afërta për sfidën që i vënë ungjillëzimit, secila sipas mënyrës së vet.

E para është ajo që mund të quhet shtimi i vazhdueshëm i mosbesimit në botën moderne. Sinodi ka kërkuar që ta përshkruajë këtë botë moderne. Sa e sa rryma mendimi, vlera dhe kundërvlera, aspirata të fshehta ose farëra shkatërrimi, bindje të vjetra që zhduken dhe bindje të reja që imponohen fshihen pas këtij emri të përgjithshëm! Nga pikëpamja shpirtërore, kjo botë moderne duket se rropatet në atë që një autor bashkëkohor e ka quajtur «drama e humanizmit ateist» (77).

Nga njëra anë, jemi të detyruar që të konstatojmë mu në zemër të kësaj bote bashkëkohore fenomenin që bëhet pothuajse shenja apo treguesi i saj më befasues: shekullarizmi. Ne nuk flasim për shekullarizimin, që është përpykja në vetvete e drejtë dhe e ligjshme, aspak i papajtueshëm me fenë dhe besimin, për të zbuluar në krijim, në çdo gjë dhe në çdo ngjarje të rruzullimit, ligjet që i drejtojnë, me një farë autonomie, në bindjen e thellë, se Krijuesi i ka vendosur këto ligje. Koncili i fundit ka pohuar, në këtë kuptim, autonominë e ligjshme të kulturës dhe veçanërisht të shkencave (78). Mirëpo, këtu, Ne shohim një shekullarizëm të vërtetë: një kuptim për botën, sipas të cilit ajo shpjegohet vetvetiu pa pasur nevojë për ndihmë nga Hyji, i cili bëhet, kështu, i kotë dhe i rëndë. Një shekullarizëm i tillë, për të njohur pushtetin e njeriut, arrin, pra, deri aty sa 'të bëjë edhe pa Hyjin' e madje edhe ta mohojë atë.

Prej kësaj duket se rrjedhin forma të reja ateizmi: një ateizëm antropocentrik, jo më abstrakt dhe metafizik, por pragmatik, programatik dhe militant. Lidhur me këtë shekullarizëm ateist, na propozohen përditë, në forma nga më të larmishmet, qytetërimi i konsumit, hedonizmi i ngritur si vlera më e lartë, vullneti për pushtet dhe sundim, diskriminime të çdo lloji, që janë prirje të tjera çnjerëzore të këtij njerëzimi.

Nga ana tjetër, po në këtë botë moderne, në mënyrë paradoksale, nuk mund të mohohet ekzistenca e lidhjeve të vërteta të krishtera, e vlerave ungjillore, të paktën në formën e një zbrazëtie ose mallëngjimit. Nuk do të ishte e ekzagjeruar të flitej për një thirrje të fortë dhe tragjike nga ana e tyre për t'u ungjillëzuar.

JO PRAKTIKUESIT

56. Një sferë e dytë është ajo e jo praktikuesve. Sot ka një numër të madh të pagëzuarish, të cilët, në një masë të gjerë, nuk e kanë mohuar formalisht Pagëzimin e tyre, por nuk e jetojnë atë dhe janë krejtësisht të cekët.

Fenomeni i jo praktikuesve është shumë i vjetër në historinë e krishterimit. Ai është i lidhur me një dobësi natyrore, me një mospërputhje të thellë që, për fat të keq, e mbartim brenda vetvetes. Mirëpo, sot ky fenomen paraqet karakteristika të reja, që shpeshherë janë pasojë e çrrënjësive tipike të epokës tonë. Ai lind edhe prej faktit se të krishterët, sot, jetojnë përbri jo besimtarëve dhe marrin vazhdimisht kundërgoditje nga mosbesimi i tyre. Për më tepër, jo praktikuesit e ditëve të sotme, më shumë sesa ata të kohëve të mëparshme, kërkojnë ta mbrojnë dhe ta arsyetojnë pozicionin e tyre në emër të një besimi të brendshëm, të autonomisë apo të vërtetësive personale.

Prandaj, ateistët dhe jobesimtarët, nga njëra anë, dhe jo praktikuesit, nga ana tjetër, i bëjnë një kundërshtim serioz ungjillëzimit. Kundërshtimi i të parëve merr formën e njëfarë refuzimi, paaftësinë për ta pranuar rendin e ri të gjërave, kuptimin e ri të botës, të jetës, të historisë, që nuk është e mundur nëse nuk nisemi nga Absolutja e Hyjit. Qëndresa e grupit të dytë merr formën e inercisë dhe sjelljen pak armiqësore të dikujt që ndihet si në shtëpinë e vet, që pohon se di gjithçka, se ka shijuar gjithçka e se nuk beson më. Shekullarizmi ateist dhe mungesa e praktikës fetare gjenden te të rriturit dhe te të rinjtë, tek elita dhe te turmat, në të gjithë

sektorët kulturorë, si në Kishat e vjetra ashtu edhe në ato të reja. Veprimi ungjillëzues i Kishës, i cili nuk mund të mos i marrë parasysh këto dy botë e as të ndalet e të ngurrojë përballë tyre, duhet të kërkojë vazhdimisht me qëndrueshmëri mjetet dhe gjuhën e përshtatshme që t'ua propozojë ose ripropozojë atyre zbulimin e Hyjit dhe fenë në Jezu Krishtin.

NË ZEMËR TË TURMAVE

57. Sikurse Krishti gjatë kohës së predikimit të tij, sikurse të Dymbëdhjetët në mëngjesin e Rrëshajëve, ashtu edhe Kisha sheh para vetes një turmë të pafund njerëzore që ka nevojë për Ungjillin dhe ka të drejtë, sepse Hyji «do që të gjithë njerëzit të shëlbohen dhe t'ia mbërrijnë njohjes së të vërtetës» (79).

E vetëdijshme për detyrën e saj që t'ua predikojë shpëtimin të gjithëve, duke e ditur se mesazhi ungjillor nuk është i rezervuar vetëm për një grup të vogël specialistësh, të privilegjuarish ose të përzgjedhurish, por i adresohet të gjithëve, Kisha e bën të vetin ankthin e Krishtit përballë turmave të shpërndara e të lodhura «si delet pa bari» dhe e përsërit shpesh fjalën e tij: «Më dhimbset ky popull» (80). Mirëpo, Kisha është edhe e vetëdijshme se, për efektshmëri të predikimit ungjillor, në zemër të turmave, ajo duhet t'ia drejtojë mesazhin e saj bashkësisë së besimtarëve, veprimi i të cilës mundet dhe duhet t'i mbërrijë të tjerët.

BASHKËSITË KISHTARE NË BAZË

58. Sinodi i fundit është marrë shumë me këto bashkësi të vogla ose «bashkësi në bazë», sepse ato përmenden shpesh në Kishën e sotme. Çfarë janë dhe për çfarë arsye këto do të ishin përfitueset e veçanta të ungjillëzimit dhe, në të njëjtën kohë, ungjillëzuese?

Sipas dëshmimeve të ndryshme të dëgjua në Sinod, bashkësi të tilla po lulëzojnë pak a shumë gjithkund në Kishë. Ato ndryshojnë shumë ndërmjet tyre, si brenda së njëjtës krahinë e edhe më shumë nga njëra krahinë në tjetrën.

Në disa krahina, ato lindin dhe zhvillohen, me disa përjashtime, brenda Kishës, të futura në jetën e saj, të ushqyera prej mësimin të saj e të bashkuara me Barinjtë e saj. Në këtë rast, ato lindin prej nevojës për ta jetuar edhe më intensivisht jetën e Kishës, ose nga dëshira dhe nga kërkimi i një përmase më njerëzore, që bashkësi kishtarë më të gjera vështirë se mund ta ofrojnë, sidomos në metropolet urbane bashkëkohore që favorizojnë jetën e turmave dhe njëherësh anonimat. Këto bashkësi mundohen vetëm që, në mënyrën e tyre, në nivelin shpirtëror dhe fetar - me kultin, me thellimin e fesë, me dashurinë vëllazërore, me lutjen dhe me bashkimin me Barinjtë - të jenë një zgjatim i bashkësisë së vogël shoqërore, si ajo e fshatit, etj.

Ose ka nga ato bashkësi që, për dëgjimin dhe meditimin e Fjalës, për kremtimin e Sakramenteve dhe për forcimin e lidhjes së Dashurisë – Agape, synojnë bashkimin e grupeve, të cilët i lidh moshë, kultura, gjendja civile ose situata shoqërore: çifte të martuara, të rinj, profesionistë, etj. Këta janë njerëz që tashmë jeta i gjen të bashkuar në luftën për drejtësi, për ndihmën vëllazërore ndaj të varfërve dhe për përparimin njerëzore. Së fundi, ka nga ato që i bëjnë bashkë të krishterët aty ku mungesa e meshtarëve nuk e favorizon jetën normale të një bashkësie famullitare. E gjithë kjo supozohet në brendësi të bashkësive të themeluara të Kishës, sidomos të Kishave vendase dhe të famullive.

Përkundrazi, në vende të tjera, bashkësitë në bazë bashkohen në një shpirt të një kritike të thartë ndaj Kishës, të cilën ato parapëlqejnë me dëshirën e tyre ta etiketojnë si «institucionale» dhe së cilës ato i kundërvihen si bashkësi karizmatike, të lira nga strukturat, të frymëzuara vetëm në Ungjill.

Kështu, ato kanë si karakteristikë të dallueshme qëndrimin akuzues dhe refuzues lidhur me hierarkinë dhe shenjat e Kishës, që janë manifestime të jashtme të saj. E kundërshtojnë rrënjësisht këtë Kishë. Në një drejtim të tillë, frymëzimi i tyre bëhet shumë shpejt ideologjik dhe është e rrallë që të mos bien, kështu, pre e një opsioni politik, e një rryme, pra, pre e një sistemi, madje e një partie, me gjithë rrezikun që sjell kjo për instrumentalizimin e tyre.

Ndryshimi është tashmë i dukshëm: bashkësitë që për shpirtin e tyre të kundërshtimit e përjashtojnë veten nga Kisha, njësinë e të cilës ato e dëmtojnë, mund ta quajnë veten si «bashkësi të bazës», por në këtë rast ky është një emërtim ngushtësisht sociologjik. Ato nuk do të mund të quheshin, pa abuzim gjuhësor, bashkësi kishtarë të bazës, edhe në qoftë se, duke qëndruar armiqësore me Hierarkinë, kanë pretendimin të qëndrojnë në njësinë e Kishës. Ky emër u përket bashkësive të tjera, atyre që mbliidhen në Kishë, me qëllimin që Kisha të rritet.

Këto bashkësi të fundit do të jenë një vend ungjillëzimi për të mirën e bashkësive më të gjera, veçanërisht të Kishave vendase dhe do të jenë një shpresë për Kishën universale, siç kemi thënë edhe në përfundim të Sinodit të lartpërmendur, në atë masë në të cilën:

- kërkojnë ushqimin e tyre në Fjalën e Hyjit dhe nuk lejojnë që të prangosen prej polarizimit politik apo prej ideologjive të kohës që janë në modë e të cilat janë gjithmonë të gatshme për ta shfrytëzuar potencialin e tyre të madh njerëzor;

- shmangin tundimin gjithmonë kërcënues të kundërshtimit sistematik dhe të shpirtit tejet kritik, me pretekstin gjoja të vërtetësisë dhe të shpirtit të bashkëpunimit;

- qëndrojnë ngultas të lidhura me Kishën vendase, në të cilën janë futur, dhe me Kishën universale, duke shmangur kështu rrezikun – për fat keq ndodh! – që të izoloohen në vetvete e të besojnë pastaj se janë e vetmja Kishë e vërtetë e Krishtit, dhe kështu t'i dënojnë bashkësitë e tjera kishtarë;

- ruajnë një bashkim të sinqertë me Barinjët që Zoti ia jep Kishës së tij dhe me Mësimin e Kishës, që Shpirti i Krishtit ua ka besuar atyre;

- nuk e çmojnë veten asnjëherë si marrësi i vetëm ose autori i vetëm i ungjillëzimit – apo edhe ruajtësi i vetëm i Ungjillit! por, të vetëdijshme se Kisha është shumë më e gjerë dhe më e larmishme, ato pranojnë që kjo Kishë të mishërohet edhe në mënyra të ndryshme prej atyre që zhvillohen në to;

- rriten çdo ditë në vetëdije, zell, angazhim dhe rrezatim misionar;

- dëftohen në gjithçka si bashkësi universale dhe jo sektare.

Sipas këtyre kushteve të lartpërmendura, që sigurisht se janë kërkuese, por edhe entuziazmuese, bashkësitë kishtarë në bazë do t'i përmbahen thirrjes së tyre themelore: si dëgjuese të Ungjillit, që u është shpallur atyre, dhe si marrëse të privileguara të ungjillëzimit, ato do të bëhen pa pengesë shpallëse të Ungjillit.

VI. Punëtorët e ungjillëzimit

NJË KISHË TËRËSISHT MISIONARE

59. Nëse ka njerëz që e shpallin në botë Ungjillin e shpëtimit, e bëjnë këtë për urdhër, në emër dhe me hirin e Krishtit Shpëtimtar. «E si do ta predikojnë pa qenë dërguar?» (81), shkruante ai që padyshim që njëri prej ungjillëzuesve më të mëdhenj. Askush nuk mund ta ushtrojë një detyrë të tillë pa qenë dërguar.

Po kush e ka, pra, misionin për të ungjillëzuar?

Koncili II i Vatikanit është përgjigjur qartë: Kishës «për mandat hyjnor i mbetet detyrimi që të shkojë në botën mbarë e t'ia predikojë Ungjillin çdo krijese» (82). Dhe në një tekst tjetër: «E gjithë Kisha është misionare dhe vepra ungjillëzuese është një detyrë themelore e popullit të Hyjit...» (83).

E kemi theksuar tashmë këtë lidhje të ngushtë mes Kishës dhe ungjillëzimit. Kur Kisha e lajmëron Mbretërinë e Hyjit dhe e ndërton atë, ajo vetë i ngul rrënjët në zemër të botës si shenjë dhe instrument i kësaj Mbretërie, që është e pranishme dhe që po vjen. Koncili e ka përdorur këtë shprehje shumë domethënëse të Shën Agustinit mbi veprimtarinë misionare të të Dymbëdhjetëve: «Ata i lindën Kishat duke predikuar fjalën e së vërtetës» (84).

NJË VEPËR KISHTARE

60. Konstatimi se Kisha është dërguar dhe se asaj i është dorëzuar porosia për ungjillëzim, do të duhej që të ngjallte në ne dy bindje.

E para: ungjillëzimi nuk është kurrë për askënd një vepër individuale dhe e izoluar, por thellësisht kishtare. Atëherë kur predikuesi, katekisti ose bariu më i panjohur, në vendin më të largët, predikon Ungjillin, e mbledh bashkësinë e tij të vogël ose shpërndan një Sakrament të caktuar, edhe nëse gjendet vetëm, ai kryen një vepër të Kishës dhe gjesti i tij është sigurisht i lidhur përmes marrëdhënieve institucionale, por edhe përmes lidhjeve të padukshme dhe rrënjëve të thella të rendit të hirit, me veprimtarinë ungjillëzuese të të gjithë Kishës. Kjo do të thotë se ai vepron jo për një mision që ia atribuon vetvetes e as në fuqinë e një frymëzimi personal, por në bashkim me misionin e Kishës dhe në emër të saj. Prej këtej rrjedh bindja e dytë: nëse secili ungjillëzon në emër të Kishës, e cila në të njëjtën kohë e bën këtë në fuqi të porosisë së Zotërisë, asnjë ungjillëzues nuk është pronari absolut i veprimit të vet ungjillëzues, me pushtet të fshehtë për ta kryer atë sipas kritereve dhe perspektivave individualiste, por duhet ta bëjë në bashkim me Kishën dhe me Barinjët e saj. Kisha, e kemi thënë tashmë, është tërësisht ungjillëzuese. Kjo do të thotë që, për botën në tërësinë e saj dhe për çdo pjesë të veçantë të botës ku ajo gjendet, Kisha ndjehet përgjegjëse e detyrës për ta përhapur Ungjillin.

PERSPEKTIVA E KISHËS UNIVERSALE

61. Në këtë pikë të reflektimit tonë, ndalemi së bashku me ju, Vëllezër dhe Bij, mbi një çështje që është veçanërisht e rëndësishme sot. Të krishterët e parë e shprehnin me gëzim – në krenimin liturgjik, në dëshminë e tyre para gjykatësve dhe xhelatëve përndjekës, në tekstet e tyre apologjetike – një fe të thellë në Kishën, duke e dëftuar atë si të përhapur në mbarë dheun. Ishin plotësisht të vetëdijshëm se i përkisnin një bashkësie të madhe, që as hapësira e as koha nuk mund ta kufizonin: «Që nga Abeli i drejtë deri në të zgjedhurin e fundit» (85), «deri në skajin e botës» (86), «deri në të sosur të botës» (87).

Të tillë e ka dashur Zotëria Kishën e tij: universale, pemë të madhe, ndër degët e së cilës zogjtë e qiellit i ngrenë foletë e tyre (88), rrjetë që mbledh çdo lloj peshku (89) ose që Pjetri e tërheq në breg plot me njëqind e pesëdhjetë e tre peshq të mëdhenj (90), grigjë e kullotur nga një bari i vetëm (91). Pra, një Kishë universale pa ndarje e pa kufij me përjashtim vetëm, e kjo për fat të keq, të atyre ndarjeve dhe kufijve të zemrës dhe të shpirtit të mëkatarit.

PERSPEKTIVA E KISHËS VENDASE

62. Megjithatë, kjo Kishë universale mishërohet, në fakt, në Kishat vendase, të përbëra njëkohësisht nga njëra ose tjetra pjesë konkrete e njerëzimit, që flasin një gjuhë të caktuar, që kanë një trashëgimi të vetën kulturore, e cila vjen nga një shtresë e caktuar njerëzore. Hapja ndaj pasurive të Kishës vendase i përgjigjet një ndjeshmërie të veçantë të njeriut bashkëkohor.

Mirëpo, duhet të kemi shumë kujdes që të mos e konceptojmë Kishën universale si shumë ose, nëse mund të themi kështu, si një federatë pak a shumë të larmishme të Kishave vendase, që në thelb janë të ndryshme. Në mendjen e Zotërisë, është vetë Kisha, e cila, duke qenë universale për nga thirrja dhe misioni, kur i ngul rrënjët e saj në shumëllojshmërinë e terreneve kulturore, shoqërore dhe njerëzore, ajo merr fizionomi dhe shprehje të jashtme të ndryshme në çdo cep të botës.

Në këtë mënyrë, çdo Kishë vendase, e cila do të ndahej vullnetarisht nga Kisha universale, do ta humbiste referimin e saj ndaj planit të Hyjit dhe do të varfërohej në përmasën e saj kishtarë. Nga ana tjetër, Kisha «toto orbe diffusa» (e shpërndarë në mbarë botën), do të bëhej një gjë abstrakte nëse nuk do të merrte trup dhe jetë pikërisht përmes Kishave vendase. Vetëm një vëmendje e përhershme ndaj dy poleve të Kishës, do të na e mundësojë perceptimin e pasurisë së kësaj marrëdhënieje mes Kishës universale dhe Kishave vendase.

PËRSHTATJA DHE BESNIKËRIA E GJUHËS

63. Të përbëra thellësisht jo vetëm prej njerëzve, por edhe prej aspiratave, pasurive dhe kufizimeve, mënyrave të lutjes, dashurisë, mënyrës se si e shohin jetën dhe botën, që shënojnë dallimin mes njerit apo tjetrit grup njerëzor, Kishat vendase kanë detyrën e përvetësimit të thelbit të mesazhit ungjillor dhe të përkthimit të tij, pa as edhe më të voglin tjetërsim të të vërtetës së vet themelore, në gjuhën e kuptuar prej këtyre njerëzve dhe pastaj ta shpallin atë po në këtë gjuhë.

Përkthimi duhet bërë me shqyrtimin, seriozitetin, respektin dhe kompetencën që kërkon vetë lënda në fushën e shprehjeve liturgjike (92), katekezës, formulimit teologjik, strukturave kishtarë dytësore dhe mbarështimeve. Dhe fjala «gjuhë» këtu duhet të kuptohet më pak në kuptimin semantik ose letrar, sesa në atë që mund të quhet antropologjik dhe kulturor.

Çështja është padyshim delikate. Ungjillëzimi e humb shumë forcën dhe efektshmërinë e vet, nëse nuk e merr parasysh popullin konkret, të cilit i drejtohet, nëse nuk përdor gjuhën e tij, shenjat dhe simbolet e tij, nëse nuk u përgjigjet problemeve të tij, nëse nuk i intereson jeta e tij reale. Por, nga ana tjetër, ungjillëzimi rrezikon që ta humbasë shpirtin e vet dhe të zbehet, nëse përmbajtja e tij mbetet e zbrazët ose e shtrembëruar me pretekstin e përkthimit apo nëse, duke dashur të përshtatë një realitet universal në një hapësirë lokale, injorohet ky realitet dhe shkatërrohet njësisia, pa të cilën nuk ka universalizëm. Pra, vetëm një Kishë që ruan vetëdijen e universalizmit të vet dhe që dëfton se është efektivisht universale, mund të ketë një mesazh të kuptueshëm për të gjithë, përtej kufijve krahinorë.

Veç të tjerash, një kujdes i ligjshëm për Kishat vendase nuk mund të bëjë gjë tjetër veçse ta pasurojë Kishën. Përkundrazi, kjo gjë është e domosdoshme dhe urgjente. Zbulimi gjithmonë e më shumë i fizionomisë vetjake përputhet edhe me aspiratat më të thella të popujve dhe të bashkësive njerëzore.

HAPJA NDAJ KISHËS UNIVERSALE

64. Mirëpo, ky pasurim kërkon që Kishat vendase të qëndrojnë thellësisht të hapura ndaj Kishës universale. Për më tepër, duhet të theksohet qartë se të krishterët më të thjeshtë, ata që janë më besnikë ndaj Ungjillit dhe më të hapur ndaj kuptimit të vërtetë të Kishës, kanë një ndjeshmëri tejet spontane për këtë përmase universale. Ata ia ndejnë fuqishëm dhe në mënyrë instiktive nevojën, e njohin veten lehtësisht në një

përmasë të tillë. Ata tingëllojnë njëzëri me të dhe vuajnë në thellësinë e tyre kur, në emër të teorive që ata nuk i kuptojnë, detyrohen që të pranojnë një Kishë, së cilës i mohohet ky universalizëm, pra, një kishë krahinore, pa horizont.

Në fakt, siç na e tregon qartë edhe historia, sa herë që një Kishë vendase është shkëputur nga Kisha universale dhe nga qendra e saj jetësore dhe e dukshme, - edhe pse disa herë me qëllimet e veta më të mira, me argumentet teologjike, shoqërore, politike apo baritore, ose edhe me dëshirën e një farë lirie të lëvizjes dhe të veprimit – ajo i është shmangur me shumë vështirësi, nëse ka mundur, dy rreziqeve njësoj të rënda. Rreziku i parë është ai i izolimit tharës, dhe si rrjedhojë, në një kohë të shkurtër, i shpërbërjes, pasi që secila prej qelizave të saj ndahet nga ajo, ashtu siç ajo vetë është ndarë prej bërthamës qendrore. Rreziku i dytë është ai i humbjes së lirisë së vet kur, e shkëputur nga qendra dhe nga Kishat e tjera, që i jepnin forcë dhe energji, e ka gjetur veten vetëm dhe pre e forcave nga më të ndryshmet të skllavërimit dhe të shfrytëzimit. Sa më shumë që një Kishë vendase qëndron e kapur me lidhje të forta bashkimi me Kishën universale, – në dashuri dhe në besnikëri, në hapje ndaj Magjisterit të Pjetrit, në bashkim me «Lex orandi» (Ligji i lutjes), që është edhe «Lex credendi» (Ligji i besimit), në kujdesin e bashkimit me të gjitha Kishat e tjera që përbëjnë universalizmin – aq më tepër vetë kjo Kishë do të jetë e aftë ta vërë në jetë thesarin e fesë në shumëllojshmërinë e ligjshme të shprehjeve të shpalljes së besimit, të lutjes dhe të kultit, të jetës së sjelljeve të të krishterëve, të ndikimit shpirtëror të popullit, pjesë e të cilit është ajo vetë. Në këtë mënyrë, ajo do të jetë vërtet edhe më shumë ungjillëzuese, domethënë e aftë për të marrë prej pasurisë universale për të mirën e popullit të saj, si edhe e aftë për t'ia komunikuar Kishës universale përvojën dhe jetën e vetë këtij populli, për të mirën e të gjithëve.

DEPOZITA E PANDRYSHUESHME E FESË

65. Pikërisht në këtë kuptim, në mbyllje të Asamblesë së tretë të Përgjithshme të Sinodit, kemi dashur të themi një fjalë të qartë dhe plot me dashuri atërore, duke këmbëngulur për rolin e Pasardhësit të Pjetrit si parim i dukshëm, i gjallë dhe dinamik i bashkimit ndërmjet Kishave dhe kështu të universalizmit të Kishës së vetme (93). Kemi këmbëngulur edhe për përgjegjësinë e rëndë që Na përket, por që e bashkëndajmë me Vëllezërit Tanë në episkopat, për të ruajtur të pandryshueshme përmbajtjen e fesë katolike, që Zotëria ua ka besuar Apostujve. Edhe pse e përkthyer në të gjitha gjuhët, kjo përmbajtje nuk duhet të jetë as e dëmtuar e as e copëtuar. Edhe pse e veshur me simbolet tipike të secilit popull, e shprehur përmes formulimeve teologjike që marrin parasysh mjediset kulturore, shoqërore dhe racore të ndryshme, përmbajtja e fesë katolike duhet të jetë gjithmonë ajo që Magjisteri kishtar e ka marrë dhe e transmeton.

DETYRA TË NDRYSHME

66. E gjithë Kisha, pra, është e thirrur të ungjillëzojë dhe megjithatë duhet të kryejë veprimtari që janë të ndryshme në fushën e vet të ungjillëzimit. Kjo larmi shërbesash në njësinë e vetë misionit përbën pasurinë dhe bukurinë e ungjillëzimit. Po i kujtojmë shkurtimisht këto detyra.

Para së gjithash na lejoni që të theksojmë këmbënguljen me të cilën Zotëria, në faqet e para të Ungjillit, ua beson Apostujve detyrën e shpalljes së Fjalës. Ai i ka zgjedhur (94), i ka formuar për disa vjet në intimitet (95), i ka themeluar (96) dhe dërguar (97) si dëshmitarë dhe mësues të autorizuar të porosisë së shpëtimit. Dhe të Dymbëdhjetët, në kohën e tyre, kanë dërguar pasardhësit e tyre, të cilët vazhdojnë ta predikojnë Lajmin e Mirë në vijën apostolike.

PASARDHËSI I PJETRIT

67. Kështu Pasardhësi i Pjetrit është i ngarkuar, për vullnet të Krishtit, me shërbesën e lartë dhe të shquar që të mësojë të vërtetën e zbuluar. Besëlidhja e Re e tregon shpesh Pjetrin «plot me Shpirtin Shenjt» që e

merr fjalën në emër të të gjithëve (98). Për këtë, Shën Leoni i Madh flet për Pjetrin si për atë që ka merituar parësinë e apostullatit (99). Prandaj, veç të tjerash, zëri i Kishës e paraqet Papën «në majën më të lartë – në kulm, në pikën më të lartë të vrojtimit – të apostullatit» (100). Koncili II i Vatikanit ka dashur që ta ritheksojë duke shpallur se «porosia e Krishtit për t'ia predikuar Ungjillin të gjithë njerëzve (krhs. Mk 16,15), i përket para së gjithash dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë pikërisht atyre (Ipeshkvijve), bashkë me Pjetrin dhe nën udhëheqjen e Pjetrit» (101).

Pushteti i plotë, më i lartë dhe universal (102) që Krishti ia ka dhënë Vikarit të tij për drejtimin baritor të Kishës, qëndron, pra, veçanërisht në veprimtarinë e ushtruar nga Papa për ta predikuar dhe për të mundësuar predikimin e Lajmit të Mirë të shpëtimit.

IPESHKVIJTË DHE MESHTARËT

68. Të bashkuar me Pasardhësin e Pjetrit, Ipeshkvijtë, pasardhësit e Apostujve, marrin, në fuqinë e shugurimit ipeshkvor, autoritetin për të mësuar në Kishë të vërtetën e zbuluar. Ata janë mësuesit e fesë.

Ipeshkvijve u bashkohen në shërbesën e ungjillëzimit, si përgjegjës me të drejtë të veçantë, ata që përmes shugurimit meshtarak «veprojnë në personin e Krishtit» (103), si edukues të Popullit të Hyjit në fe, predikues, duke vepruar në të njëjtën kohë si mbarështues të Eukaristisë dhe të Sakramenteve.

Prandaj, të gjithë në Barinj të jemi të ftuar, më shumë se çdo gjymtyrë tjetër e Kishës, që të jemi të ndërgjegjshëm për këtë detyrë. Ajo që përbën veçantinë e shërbesës sonë meshtarake, ajo që i jep një njësi të thellë mijëra detyrave që na shoqërojnë gjatë gjithë rrjedhës së jetës tonë, ajo që i jep veprimtarive tona një rëndësi të veçantë, është ky qëllim i pranishëm në çdo veprim tonin: «Shpallja e Ungjillit të Hyjit» (104). Ja një tipar i identitetit tonë, të cilin asnjë dyshim nuk do të duhej ta dëmtonte e asnjë kundërshtim nuk do të duhej ta errësonte: si Barinj, kemi qenë zgjedhur prej mëshirës së Bariut më të lartë (105), pavarësisht pamjaftueshmërisë tonë, për ta shpallur me autoritet Fjalën e Hyjit, për ta mbledhur Popullin e Hyjit që ishte i shpërndarë, për ta ushqyer këtë popull me shenjat e veprimit të Krishtit, që janë Sakramentet, për ta çuar atë në rrugën e shpëtimit, për ta ruajtur në atë njësi për të cilën ne vetë jemi, në nivele të ndryshme, vegla vepruese dhe jetësore, për ta gjallëruar pa pushim këtë bashkësi të mbledhur rreth Krishtit, sipas thirrjes së tij më të thellë. Dhe kur, në masën e kufijve tanë njerëzorë e sipas hirit të Hyjit, ta përmbushim gjithë këtë, ne kryejmë një vepër ungjillëzimi: Ne si Bari i Kishës universale, Vëllezërit Tanë në episkopat në drejtim të kishave vendase, meshtarët dhe diakonët të bashkuar me Ipeshkvijtë e tyre, bashkëpunëtorët e të cilëve janë përmes një bashkimi që e ka burimin e tij në Sakramentin e Urdhrit të shenjtë dhe në dashurinë e Kishës.

RREGULLTARËT

69. Rregulltarët, gjithashtu, gjejnë në jetën e kushtuar një mjet të privilegjuar për një ungjillëzim të efektshëm. Në nivelin më të thellë të qenies së tyre, ata vendosen në dinamizmin e Kishës, e cila është e etur për Absoluten e Hyjit dhe e thirrur në shenjtëri. Ata janë dëshmitarë të kësaj shenjtërie. E mishërojnë Kishën, e cila aq shumë dëshiron t'i braktiset kërkesave rrënjësore të lumturive. Me jetën e tyre, ata janë shenja e gatishmërisë së tyre të plotë ndaj Hyjit, ndaj Kishës dhe ndaj vëllezërve.

Në këtë pikëpamje, ata marrin një rëndësi të veçantë në kontekstin e një dëshmie që, siç kemi pohuar, është parësore në ungjillëzim. Kjo dëshmi e heshtur e varfërisë dhe e shkëputjes (prej gjërave të kësaj bote), e pastërtisë dhe e transparencës, e braktisjes në dëgjuesë, mund të bëhet, përveçse një nxitje për botën dhe vetë Kishën, edhe një predikim shprehës, në gjendje që t'u bëjë përshtypje edhe jo të krishterëve vullnetmirë, të ndjeshëm ndaj disa vlerave.

Në këtë perspektivë, perceptohet roli që luajnë në ungjillëzim rregulltarët dhe rregulltarët e kushtuar lutjes, qetësisë, pendesës dhe vetëfljimit. Rregulltarë të tjerë, në një numër shumë të madh, i kushtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë shpalljes së Krishtit. Veprimi i tyre misionar varet qartësisht nga hierarkia dhe duhet të

bashkërendohet me baritoren që vetë hierarkia dëshiron ta vendosë në veprim. Po kush nuk e çmon frytin e madh që ata i kanë dhënë dhe vazhdojnë t'i japin ungjillëzimit? Falë kushtimit të tyre rregulltar, ata janë në mënyrë të shkëlqyer vullnetarë dhe të lirë që të lënë gjithçka e të shkojnë për ta shpallur Ungjillin deri në skajet e botës. Ata janë sipërmarrës dhe apostullati i tyre shënohet shpesh nga një origjinalitet dhe një gjenialitet që të detyrojnë t'i admirosh. Janë bujarë: gjenden shpesh në vende të përparuara të misionit dhe marrin mbi vete rreziqet më të mëdha për shëndetin e tyre dhe për vetë jetën e tyre. Po, me të vërtetë, atyre Kisha iu detyrohet shumë.

LAIKËT

70. Laikët, të cilët thirrja e tyre e veçantë i vë në mes të botës dhe në drejtimin e detyrave tokësore nga më të ndryshmet, duhet të ushtrojnë pikërisht për këtë arsye një formë të veçantë ungjillëzimi.

Detyra e tyre parësore dhe e menjëhershme nuk është themelimi dhe zhvillimi i bashkësisë kishtare – gjë që është roli i posaçëm i Barinjve – por është vënia në veprim e të gjitha mundësive të krishtera dhe ungjillore të fshehta, por që janë tashmë të pranishme dhe vepruese në realitetin e botës. Fusha specifike e veprimit të tyre ungjillëzues është bota e gjerë dhe e ndërlikuar e politikës, e realitetit shoqëror, e ekonomisë; ashtu edhe ajo e kulturës, e shkencave dhe e arteve, e jetës ndërkombëtare, e mjeteve të komunikimit shoqëror; si edhe e realiteteve të tjera që janë veçanërisht të hapura ndaj ungjillëzimit, si dashuria, familja, edukimi i fëmijëve dhe i të rinjve, puna profesionale dhe vuajtja. Sa më shumë të ketë laikë të përshkruar nga shpirti ungjillor, të përgjegjshëm për këto realitete dhe të angazhuar në to në mënyrë të hapur, të aftë për nxitjen e tyre dhe të vetëdijshëm se duhet ta zhvillojnë të gjithë aftësinë e tyre të krishterë, të cilës shpesh i zihet fryma dhe mbahet e fshehur, aq më tepër këto realitete, pa humbur e pa flijuar asgjë prej koeficientit të tyre njerëzor, por duke shfaqur një përmasë trashëdente shpesh të panjohur, do të gjenden në shërbim të ndërtimit të Mbretërisë së Hyjit dhe kështu të shpëtimit në Jezu Krishtin.

FAMILJA

71. Në fushën e apostullatit të ungjillëzimit që i përket laikëve, është e pamundur të mos theksohet veprimi ungjillëzues i familjes. Është me shumë vend përcaktimi i bukur i “Kishës shtëpiake”, që i është bërë familjes në momente të ndryshme të historisë së Kishës dhe që është miratuar nga Koncili II i Vatikanit (106). Kjo do të thotë që, në çdo familje të krishterë, do të duhej që të vëreheshin aspektet e ndryshme të mbarë Kishës. Përveç të tjerash, familja, sikurse Kisha, duhet të jetë një hapësirë në të cilën transmetohet Ungjilli dhe prej së cilës Ungjilli rrezatohet.

Pra, në brendësinë e një familjeje të vetëdijshme për këtë mision, të gjithë pjesëtarët e familjes ungjillëzojnë dhe ungjillëzohen. Prindërit, jo vetëm që ua komunikojnë fëmijëve Ungjillin, por mund të marrin prej tyre të njëjtin Ungjill thellësisht të jetuar. Dhe një familje e tillë bëhet ungjillëzuese e shumë familjeve të tjera dhe e mjedisit në të cilin ndodhet. Edhe familjet e lindura nga një martesë e përzier e kanë për detyrë që t'ua shpallin Krishtin fëmijëve të tyre në plotësinë e asaj çka rrjedh nga Pagëzimi, të cilin e kanë të përbashkët; ato kanë, gjithashtu, edhe detyrën jo të lehtë që të bëhen edhe përnxitëse të bashkimit.

TË RINJTË

72. Rrethanat na ftojnë që t'i kushtojmë një vëmendje krejt të veçantë të rinjve. Shtimi i tyre në numër dhe prania e tyre gjithnjë e në rritje në shoqëri, si edhe problemet që i mundojnë të rinjtë, duhet të rizgjojnë te të gjithë shqetësimin që me zell dhe me mençuri t'u ofrohet atyre ideali ungjillor, ashtu që ta njohin dhe ta jetojnë atë. Mirëpo, nga ana tjetër, duhet që të rinjtë, të formuar mirë në fe dhe në lutje, të bëhen, gjithnjë e më shumë, apostuj të rinisë. Kisha beson dhe mbështetet shumë në ndihmesën e tyre dhe madje edhe vetë Ne, shpeshherë, e kemi shfaqur besimin tonë të plotë ndaj tyre.

MBARËSHTIME TË NDRYSHME

73. Në këtë mënyrë, prania aktive e laikëve në realitetet e botës e fiton krejt rëndësinë e vet. Megjithatë, nuk duhet të anashkalohej apo të harrohet aspekti tjetër: laikët mund të ndihen edhe të thirrur ose të jenë të thirrur për të bashkëpunuar me Barinj të tyre në shërbim të bashkësisë kishtare për rritjen dhe gjallërimin e kësaj të fundit, duke ushtruar shërbesa nga më të ndryshmet, sipas hirit dhe karizmave që Zoti do të dojë t'ua shpërndajë atyre.

Ndajmë një gëzim të madh në thellësinë e shpirtit tonë kur vërejmë një shumicë Barinjsh, rregulltarësh dhe laikësh, të cilët, të dhënë me shpirt pas misionit të tyre ungjillëzues, kërkojnë mënyra gjithnjë e më të përshtatshme për ta shpallur Ungjillin në mënyrë të efektshme. Ne inkurajojmë hapjen që, në këtë drejtim dhe me këtë përkujdesje, Kisha po e kryen sot, para së gjithash, hapjen ndaj reflektimit, pastaj ndaj mbarështimeve kishtare që janë në gjendje ta rinojnë dhe ta forcojnë dinamizmin e saj ungjillëzues. Sigurisht, krahas mbarështimeve të shuguruara, falë të cilave disa janë caktuar edhe si Barinj dhe i kushtohen në mënyrë të veçantë shërbimit të bashkësisë, Kisha e pranon rolin e mbarështimeve jo të shuguruara, por të përshtatshme për të siguruar shërbime të veçanta të vetë Kishës.

Një shikim në fillimet e Kishës hedh shumë dritë dhe na lejon që të përfitojmë prej një përvoje të hershme të mbarështimeve. Ajo merr një vlerë edhe më të madhe kur mendojmë se ka bërë të mundur që Kisha ta konsolidojë veten, të rritet dhe të zgjerohet. Mirëpo, kjo vëmendje ndaj burimeve duhet të plotësohet nga ajo vëmendje që duhet treguar për nevojat e tanishme të njerëzimit dhe të Kishës. Të shuash etjen në këto burime gjithmonë frymëzuese, pa flijuar asgjë prej këtyre vlerave dhe njëkohësisht të dish t'iu përshtatesh kërkesave dhe nevojave aktuale - këto janë vijat udhëzuese që do të lejojnë studimin me urti dhe vlerësimin e mbarështimeve, për të cilat ka nevojë Kisha dhe që shumë anëtarë të saj do t'i përqafojnë me gëzim për gjallërimin më të madh të bashkësisë kishtare. Këto mbarështime do të kenë një vlerë të vërtetë baritore në masën në të cilën do të themelohen me respektin absolut për bashkimin dhe duke ndjekur udhëzimet e Barinjve, që janë pikërisht përgjegjësit dhe autorët e njësisë së Kishës.

Mbarështime të tilla, të reja në dukje por shumë të lidhura me përvojat e jetuara nga Kisha në rrjedhën e ekzistencës së saj, - për shembull përvojat si katekistë, gjallërues të lutjes dhe të këngës, të krishterë të përkushtuar shërbimit të Fjalës së Hyjit ose ndihmës ndaj vëllezërve në nevojë, deri madje edhe si drejtues të bashkësive të vogla, përgjegjës të lëvizjeve apostolike ose përgjegjës të tjerë - janë të çmueshme për themelimin (*plantatio*), jetën dhe rritjen e Kishës dhe për një aftësi të rrezatimit përreth saj dhe ndaj atyre që janë larg. Ne i detyrohemi me një respekt të veçantë të gjithë laikëve, të cilët pranojnë që ta kushtojnë një pjesë të kohës e të energjive të tyre dhe shpeshherë edhe krejt jetën e tyre në shërbim të misioneve.

Për të gjithë punëtorët e ungjillëzimit është e nevojshme një përgatitje serioze. Kjo është edhe më shumë e nevojshme për ata që i përkushtohen mbarështimit të Fjalës. Të gjallëruar nga bindja vazhdimisht e thelluar e madhësisë dhe e pasurisë së Fjalës së Hyjit, ata që kanë detyrën e transmetimit të saj duhet të tregojnë kujdesin më të madh ndaj dinjitetit, saktësisë dhe përshtatjes së gjuhës së tyre. Të gjithë e dinë se arti i të folurit ka një rëndësi të madhe sot. Si do të mund ta anashkalojnë këtë fakt predikuesit dhe katekistët?

Ne urojmë ngrohtësisht që, në secilën kishë vendase, Ipeshkvijtë të përkujdesen për formimin e duhur të të gjithë mbarështuesve të Fjalës. Kjo përgatitje serioze do të rrisë në ta sigurinë e domosdoshme, por edhe entuziazmin për ta shpallur Jezu Krishtin sot.

VII. Shpirti i Ungjillëzimit

NJË THIRRJE URGJENTE

74. Nuk do të donim ta përfundonim këtë bashkëbisedim me Vëllezërit dhe Bijtë tanë fort të dashur, pa një thirrje urgjente që lidhet me qëndrimet e brendshme që duhet të ngjallin punëtorët e ungjillëzimit. Në emër të Zotërisë Jezus dhe në emër të Pjetrit dhe Palit Apostuj, Ne i nxisim të gjithë ata të cilët, falë karizmave të Shpirtit Shenjt dhe porosisë së Kishës, janë ungjillëzues të vërtetë, që të jenë të denjë për këtë thirrje, që ta ushtrojnë atë pa ngurrimet e dyshimit dhe të frikës, dhe të mos lënë mënjanë kushtet që do ta bëjnë një ungjillëzim të tillë jo vetëm të mundur, por edhe aktiv dhe të frytshëm. Ja kushtet themelore që, ndër shumë të tjera, Ne dëshirojmë t'i vëmë në dukje.

NËN FRYMËN E SHPIRTIT SHENJT

75. Ungjillëzimi nuk do të jetë kurrë i mundur pa veprimin e Shpirtit Shenjt. Shpirti zbret mbi Jezusin e Nazaretit në çastin e Pagëzimit, kur zëri i Atit – «Ky është Biri im i dashur, të cilin e kam për zemër!» (107) – shfaq ndjeshëm zgjedhjen dhe misionin e tij. «I udhëhequr prej Shpirtit», Ai e jeton në shkretëtirë luftën vendimtare dhe provën më të lartë para se ta fillonte një mision të tillë (108). «Me fuqinë e Shpirtit» (109), Ai kthehet në Galile dhe në Nazaret fillon predikimin e tij, duke ia veshur vetvetes pjesën e Isaisë profet: «Shpirti i Zotit është mbi mua». «Sot – shpall Ai - shkoj në vend kjo pjesë e Shkrimit të shenjtë» (110). Nxënësve, në çastin e dërgimit, u thotë duke hukatur mbi ta: «Merrni Shpirtin Shenjt» (111).

Në fakt, vetëm pas zbritjes së Shpirtit Shenjt, në ditën e Rrëshajëve, apostujt nisen në të katër anët e botës për të filluar veprën e madhe të ungjillëzimit të Kishës dhe Pjetri e shpjegon ngjarjen si realizimin e profecisë së Joelit: «Do ta ndikoj Shpirtin tim» (112). Pjetri u mbush me Shpirtin Shenjt për t'i folur popullit për Jezusin, Birin e Hyjit (113). Gjithashtu, edhe Pali u mbush me Shpirtin Shenjt (114) para se t'i përkushtohet shërbesës së tij apostolike, ashtu siç ishte i mbushur edhe Shën Shtjefni kur u zgjodh për të ushtruar shërbesën e tij të diakonit dhe më vonë për dëshminë e martirizimit (115). I njëjti Shpirt që e bën të flasë Pjetrin, Palin apo Apostujt e tjerë, duke u frymëzuar atyre fjalët që duhet të thonë, zbret edhe «mbi të gjithë ata që po dëgjonin predikimin» (116).

Kisha «rritet» «e mbushur me ngushëllimin e Shpirtit Shenjt» (117). Shpirti Shenjt është fryma e kësaj Kise. Është Ai që u shpjegon besimtarëve kuptimin e thellë të mësimin të Jezusit dhe të misterit të tij. Është Ai që, sot sikurse në fillimet e Kishës, vepron në çdo ungjillëzues që lejon të zotërohet dhe të udhëhiqet prej tij, që i sugjeron fjalët të cilat nuk do të dinte t'i gjente prej vetvetes, duke e përgatitur në të njëjtën kohë shpirtin e atij që dëgjon që të jetë i hapur për ta pranuar Lajmin e Mirë dhe Mbretërinë e shpallur.

Teknikat e ungjillëzimit janë të mira, por as ato më të përsosurat ndër to nuk do të mund ta zëvendësonin dot veprimin e fshehtë të Shpirtit Shenjt. Edhe përgatitja më e shkëlqyer e ungjillëzuesit nuk vepron asgjë pa Shpirtin Shenjt. Pa të, edhe dialektika më bindëse është e pafuqishme mbi shpirtin e njerëzve. Pa të, edhe skemat më të përpunuara me bazë sociologjike ose psikologjike rezultojnë të zbrazëta dhe pa vlerë.

Ne po jetojmë në Kishë një çast të privilegjuar të Shpirtit Shenjt. Kërkohet gjithkund që ky Shpirt të njihet më mirë, siç zbulohet prej Shkrimit Shenjt. Ka njerëz që ndihen të lumtur të vihen nën nxitjen e tij. Mblidhen rreth tij dhe duan ta lënë veten të udhëhiqen prej tij. E po mirë, nëse Shpirti i Hyjit e ka një vend parësor në të gjithë jetën e Kishës, Ai vepron mbi të gjitha në misionin ungjillëzues: jo rastësisht fillimi i madh i ungjillëzimit ndodhi në mëngjesin e Rrëshajëve, nën frymën e Shpirtit Shenjt.

Mund të thuhet se Shpirti Shenjt është vepruesi kryesor i ungjillëzimit: është ai që shtyn përpara për ta shpallur Ungjillin e që në thellësinë e ndërjegjes bën që të pranohet dhe të kuptohet fjala e shpëtimit (118). Mirëpo, njësoj mund të thuhet se Ai është edhe pikëmbërritja e ungjillëzimit: vetëm Ai e ngjall krijimin e ri, njerëzimin e ri, të cilit duhet t'i drejtohet ungjillëzimi, me atë bashkim në shumëllojshmërinë që ungjillëzimi synon të shkaktojë në bashkësinë e krishterë. Përmes tij, Ungjilli depërton në zemër të botës,

sepse Ai udhëheq në shqyrtimin e shenjave të kohërave – shenja të Hyjit – që ungjillëzimi i zbulon dhe i jep vlerë në histori.

Sinodi i Ipeshkvijve i vitit 1974, i cili ka këmbëngulur shumë mbi rolin e Shpirtit Shenjt në ungjillëzim, ka shprehur edhe dëshirën që Barinjtë dhe teologët - e Ne do të shtojmë edhe besimtarët, të shënuar me vulën e Shpirtit me anë të Pagëzimit – ta studiojnë më mirë natyrën dhe mënyrën e veprimit të Shpirtit Shenjt në ungjillëzimin e sotëm. Ta bëjmë tonën këtë dëshirë, ndërsa i nxisim njëkohësisht ungjillëzuesit – kushdo qofshin ata – që ta lusin pa pushim Shpirtin Shenjt me fe e zell dhe të lejojnë me maturi që të udhëhiqen prej tij si frymëzuesi vendimtar i programeve, nismave dhe veprimtarisë së tyre ungjillëzuese.

DËSHMITARË TË VËRTETË

76. Le të shqyrtojmë tani vetë personin e ungjillëzuesit. Përsëritet shpesh, sot, se shekulli ynë ka etje për vërtetësi. Mbi të gjitha, në lidhje me të rinjtë, pohohet se e kanë tmerr atë që është artificiale, atë që është e rrejshme dhe kërkojnë mbi çdo gjë të vërtetën dhe transparencën.

Këto «shenja të kohërave» do të duhej të na gjenin zgjuar. Me gojë mbyllur apo me zë të lartë, por gjithmonë na pyesin: Me të vërtetë besoni në atë që shpallni? A e jetoni atë që e besoni? Dëshmia e jetës është bërë më shumë se kurrë një kusht thelbësor për efektshmërinë e thellë të predikimit. Për këtë arsye, ja ku jemi përgjegjës, deri në një farë pike, për suksesin e Ungjillit që shpallim. «Çfarë po ndodh me Kishën tani që kanë kaluar dhjetë vjet nga përfundimi i Koncilit?», pyesnim në fillim të këtij meditimi. A është ajo me të vërtetë e rrënjësuar në zemër të botës e megjithatë mjaft e lirë dhe e pavarur për ta tërhequr vëmendjen e botës? A jep ajo dëshmi për solidaritetin e vet ndaj njerëzve dhe në të njëjtën kohë ndaj Absolutes së Hyjit? A është më e zjarrtë në soditje dhe adhurim e njëkohësisht më e zellshme në veprimin misionar, bamirës dhe çlirues? A është gjithmonë e më e angazhuar në përpjekjen për të kërkuar rivendosjen e bashkimit të plotë të të krishterëve, që e bën më të frytshme dëshminë e përbashkët «që bota të besojë» (119)? Të gjithë jemi përgjegjës për përgjigjet që do të mund t'u jepeshin këtyre pyetjeve.

Ne i nxisim, pra, Vëllezërit tanë në episkopat, të cilët janë vënë aty prej Shpirtit Shenjt që ta udhëheqin Kishën (120). I nxisim meshtarët dhe diakonët, që janë bashkëpunëtorë të Ipeshkvijve për ta mbledhur popullin e Hyjit dhe për t'i gjallëruar shpirtërisht bashkësitë vendase. I nxisim rregulltarët, të cilët janë dëshmitarë të një Kise që është e thirrur në shenjtëri dhe kështu edhe ata vetë janë të thirrur për një jetë që i jeton lumturitë e Ungjillit. I nxisim laikët: familjet e krishtera, të rinjtë dhe të rriturit, të gjithë ata që ushtrojnë një profesion, drejtuesit, pa harruar të varfrit që shpesh janë të pasur me fe dhe me shpresë, të gjithë laikët e vetëdijshëm për rolin e tyre të ungjillëzimit në shërbim të Kishës ose në mes të shoqërisë dhe të botës. Ua themi të gjithëve: duhet që zelli ynë për ungjillëzimin të burojë nga një shenjtëri e vërtetë jete dhe që predikimi, i ushqyer nga lutja dhe mbi të gjitha nga dashuria për Eukaristinë, nga ana e vet – siç na kujton Koncili II i Vatikanit – të bëjë që të rritet në shenjtëri njeriu që predikon (121).

Bota, që pavarësisht shenjave të shumta të refuzimit të Hyjit, e kërkon atë në mënyrë paradoksale përmes rrugëve të papritura dhe ia ndjen dhimbshëm nevojën, lyp ungjillëzues që t'i flasim për një Hyj, që ata ta njohin dhe që t'u jetë atyre i afërt, si ta shihnin të Padukshmin (122). Bota kërkon dhe pret prej nesh thjeshtësi jete, shpirt lutjeje, dashuri ndaj të gjithëve e në mënyrë të veçantë ndaj më të vegjëlve dhe të varfërve, dëgjësë dhe përvujtëri, shkëputje prej vetvetes dhe vetëmohim. Pa këtë vulë shenjtërie, fjala jonë vështirë se do ta hapë rrugën për në zemrën e njeriut të kohës sonë, por rrezikon që të jetë e kotë dhe e pafrytshme.

NDËRTUES TË BASHKIMIT

77. Forca e ungjillëzimit do të jetë shumë më e dobët nëse ata që e shpallin Ungjillin janë të ndarë mes tyre nga shumë lloj ndarjesh. A nuk do të qëndronte ndoshta pikërisht këtu një prej sëmundjeve të mëdha të ungjillëzimit sot? Në fakt, nëse Ungjilli që e shpallim duket i copëtuar prej diskutimeve doktrimore, prej

polarizimeve ideologjike ose prej dënimeve të ndërsjella mes të krishterëve në kujdes për teoritë e tyre të ndryshme mbi Krishtin dhe mbi Kishën, dhe edhe për shkak të botëkuptimeve të tyre të ndryshme mbi shoqërinë dhe institucionet njerëzore, si do të mundën ata, të cilëve u drejtohet predikimi ynë, të mos ndihen të shqetësuar, të çorientuar, nëse jo edhe të shkandulluar?

Testamenti shpirtëror i Zotërisë na thotë se bashkimi mes ndjekësve të tij nuk është vetëm prova se ne jemi të tijtë, por edhe se Ai është i dërguari i Atit, kriter besueshmërie i të krishterëve dhe i vetë Krishtit. Si ungjillëzues, ne duhet t'u ofrojmë besimtarëve të Krishtit imazhin jo të njerëzve të ndarë dhe të përçarë prej grindjeve që nuk ndërtojnë aspak, por të personave të pjekur në fe, të aftë që të gjenden së bashku përmbi tensionet konkrete, falë kërkimit të përbashkët, të sinqertë dhe në interes të së vërtetës. Po, fati i ungjillëzimit është sigurisht i lidhur me dëshminë e bashkimit që jep Kisha. Është ky një motiv përgjegjësie, por edhe ngushëllimi.

Në këtë pikë duam të nënvizojmë shenjë e bashkimit mes të gjithë të krishterëve si rrugë dhe instrument ungjillëzimi. Ndarja e të krishterëve është një gjendje e rëndë faktike që arrin ta dëmtojë vetë veprën e Krishtit. Koncili II i Vatikanit pohon me shndritje dhe vendosmëri se ndarja «paragjykohe rëndë lidhur me çështjen e shenjtë të predikimit të Ungjillit të gjithë njerëzve dhe i pengon shumë njerëz që ta përqafojnë fenë» (123). Për këtë arsye, në shpalljen e Vitit të Shenjtë e kemi çmuar të domosdoshme t'ua kujtojmë të gjithë besimtarëve të botës katolike se «pajtimi i të gjithë njerëzve me Hyjin, Atin tonë, varet nga rivendosja e bashkimit të atyre që tashmë e kanë njohur dhe pranuar në fe Jezu Krishtin si Zotin e mëshirës që i çliron njerëzit dhe i bashkon në Shpirtin e dashurisë dhe të së vërtetës» (124).

Ne, me një ndjenjë të fortë shprese, i shohim përpjekjet që bëhen në botën e krishterë për një rivendosje të tillë të bashkimit të plotë të dëshiruar prej Krishtit. Shën Pali na siguron kur thotë: «shpresa nuk turpëron» (125).

Ndërsa punojmë ende që ta marrim prej Zotit bashkimin e plotë, duam që ta shtojmë edhe më shumë lutjen. Përveç të tjerash, ne e bëjmë të tonin angazhimin e Etërve të Asamblesë së Tretë të Përgjithshme të Sinodit të Ipeshkvijve, që të bashkëpunohet me një angazhim më të madh me vëllezërit e krishterë, duke u bazuar mbi themelin e Pagëzimit dhe mbi pasurinë e përbashkët të fesë, për t'i dhënë që tani, në vetë veprën e ungjillëzimit, një dëshmi më të gjerë të përbashkët Krishtit përpara botës. Urdhri i Krishtit na nxit në këtë; e kërkon detyra për ta predikuar dhe për ta dëshmuar Ungjillin.

SHËRBËTORË TË SË VËRTETËS

78. Ungjilli që na ka qenë besuar është edhe fjalë e së vërtetës. Ajo çfarë kërkojnë njerëzit kur ua shpallim atyre Lajmin e Mirë është e vërteta që çliron (126), e cila është edhe e vetmja që mund ta dhurojë paqen e zemrës. E vërteta mbi Hyjin, e vërteta mbi njeriun dhe mbi fatin e tij të mistershëm, e vërteta mbi botën. E vërteta e vështirë që e kërkojmë në Fjalën e Hyjit dhe për të cilën, e përsërisim, nuk jemi as pronarët, as gjyqtarët, por ruajtësit, lajmëtarët dhe shërbëtorët e saj.

Prej çdo ungjillëzuesi pritët që të ketë kultin e së vërtetës, aq më tepër që e vërteta të cilën ai e shpall dhe e thellon është e vërtetë e zbuluar dhe kështu – më shumë se çdo tjetër – pjesë e së vërtetës zanafillore, që është vetë Hyji. Predikuesi i Ungjillit do të jetë, pra, ai që, edhe pse kjo gjë i kushton vetëmohim personal dhe vuajtje, kërkon gjithmonë të vërtetën që duhet t'ua transmetojë të tjerëve. Ai nuk e tradhton, as nuk e fsheh kurrë të vërtetën për t'i pëlqyer njerëzve, për të çuditur apo për të habitur njerëzit, as për origjinalitet apo për dëshirë që të duket. Ai nuk e refuzon të vërtetën; nuk e lë në errësirë të vërtetën e zbuluar për shkak se përton ta kërkojë atë, për rehati apo për frikë. Nuk e lë pa e studiuar; i shërben bujarisht, pa e skllavëruar. Si Barinj të popullit besimtar, shërbimi ynë baritor na nxit që ta ruajmë, ta mbrojmë dhe ta komunikojmë të vërtetën pa marrë parasysh sakrificat. Barinj të shumtë, të ndritur dhe të shenjtë na kanë lënë shembullin e kësaj dashurie – në shumë raste heroike – për të vërtetën. Hyji i së vërtetës pret që ne të jemi mbrojtësit vigjilues dhe predikuesit e përshpirtshëm. Të gjithë sa jeni doktorë, teologë, ekzegetë, studiues të historisë: vepra e ungjillëzimit ka nevojë për punën tuaj të palodhshme të kërkimit, e aq më tepër edhe për kujdesin

dhe ndjeshmërinë tuaj në përçimin e së vërtetës me të cilën studimet tuaja ju afrojnë, por që është gjithmonë më e madhe se zemra e njeriut, sepse është vetë e vërteta e Hyjit.

Prindër dhe mësues, detyra juaj – të cilën konfliktet e shumta aktuale sigurisht se nuk e bëjnë të lehtë – është që t'i ndihmoni fëmijët dhe nxënësit tuaj në zbulimin e së vërtetës, duke përfshirë të vërtetën fetare dhe shpirtërore.

TË GJALLËRUAR NGA DASHURIA

79. Vepra e ungjillëzimit kërkon që ungjillëzuesi të ketë një dashuri vëllazërore gjithmonë në rritje ndaj atyre që ai ungjillëzon. Pali Apostulli, modeli i çdo ungjillëzuesi, u shkruante selanikasve këto fjalë, që janë programi për të gjithë ne: «Këndeje, prej dashurisë që kemi për ju, ishim të gatshëm t'ju shpallim jo vetëm Ungjillin e Hyjit, por t'ju jepnim edhe jetën tonë, kaq ju kemi pasur për zemër» (127). Çfarë lidhje dashurie është kjo? Kjo është një lidhje dashurie krejtësisht e ndryshme nga ajo e një pedagogu, është ajo e një babai; madje edhe më shumë: është dashuria e një nëne (128). Zoti e pret një lidhje të tillë dashurie prej secilit predikues të Ungjillit dhe prej çdo ndërtuesi të Kishës. Një shenjë e dashurisë do të jetë kujdesi për ta dhuruar të vërtetën dhe për t'i çuar njerëzit në bashkim. Gjithashtu, një shenjë e dashurisë do të jetë edhe përkushtimi pa rezerva e pa shmangie për shpalljen e Jezu Krishtit. Të shtojmë edhe ndonjë shenjë tjetër të kësaj dashurie.

Shenja e parë është respekti për gjendjen fetare dhe shpirtërore të njerëzve që ungjillëzohen, respekt për ritmin e tyre, të cilin nuk kemi të drejtë ta shtyjmë tej masës së duhur, respekt për ndërgjegjen e tyre dhe për bindjet e tyre, pa asnjë ngurtësi.

Një shenjë tjetër është kujdesi që të mos plagoset tjetri, mbi të gjitha nëse ai është i dobët në fe (129), me pohime që mund të jenë të qarta për të formuarit, por që për besimtarët e thjeshtë bëhen burim turbullimi dhe shkandulli, si një plagë në shpirt.

Një shenjë e dashurisë do të jetë edhe përpjekja për t'u përçaruar të krishterëve jo dyshime dhe pasiguri që lindin nga një mësim i përvetësuar keq, por disa siguri që janë të forta, pasi janë të ngulura në Fjalën e Zotit. Besimtarët kanë nevojë për këto siguri për jetën e tyre të krishterë, kanë të drejtën që t'i kenë, pasi janë bijtë e Hyjit që e braktisin vetveten plotësisht në krahët e tij dhe në kërkesat e dashurisë.

ME ZELL SHENJTËRISH

80. Thirrja jonë frymëzohet këtu në zellin e shenjtërve më të mëdhenj predikues dhe ungjillëzues, jeta e të cilëve i qe përkushtuar apostullatit: dhe ndër ta na pëlqen veçanërisht të vëmë në dukje ata që Ne, në këtë Vit të Shenjtë, ia kemi propozuar nderimit të besimtarëve. Ata kanë ditur t'i tejkalojnë shumë pengesa që i dilnin ungjillëzimit.

Ndër këto pengesa, të cilat janë edhe të kohëve tona, Ne do të kufizohemi që të nënvizojmë mungesën e zellit; shumë më e rëndë sepse lind nga brendësia. Kjo shfaqet në neglizhencën dhe mbi të gjitha në mungesën e gëzimit dhe të shpresës. Ne, për më tepër, i nxisim të gjithë ata që kanë, me ndonjë titull dhe në ndonjë nivel, detyrën e ungjillëzimit që ta ushqejnë zellin e shpirtit (130). Ky zell kërkon para së gjithash që të dimë të shkëputemi prej arsytimeve që mund të na shmangin nga ungjillëzimi. Më kërcënuese janë sigurisht ato për të cilat pretendohet që të gjendet mbështetje në këtë apo në atë mësim të Koncilit.

Kështu, ndodh që të dëgjohet tepër shpesh të thuhet, nën forma të ndryshme: imponimi i një të vërtete, qoftë edhe ajo e Ungjillit, imponimi i një rruge, qoftë edhe ajo e shpëtimit, nuk mund të jetë gjë tjetër veçse një dhunë ndaj lirisë fetare. Për më tepër, shtojnë, përse të shpallet Ungjilli kur të gjithë janë të shpëtuar nga ndershmeria e zemrës? Nëse, nga ana tjetër, bota dhe historia janë plot me «farëra të Fjalës», a nuk është një iluzion të pretendosh që ta çosh Ungjillin atje ku ai tashmë ai gjendet në farërat, që vetë Zoti i ka hedhur? Kushdo që kujdeset për t'i thelluar, në dokumentet konciliare, pyetjet që këto arsytime nxjerrin në mënyrë tepër sipërfaqësore, do të gjejë një vizion krejtësisht tjetër të realitetit.

Sigurisht se do të ishte një gabim t'i imponosh diçka ndërgjegjes së vëllezërve tanë. Mirëpo, t'ia propozosh kësaj ndërgjegjeje të vërtetën ungjillore dhe shpëtimin në Jezu Krishtin me qartësi të plotë dhe në respekt absolut të opsioneve të lira që do të japë ajo – pa «shtytje shtrënguese ose nxitje të pandershme apo stimuj jo të drejtë» (131) – largqoftë nga të qenurit një atentat kundër lirisë fetare, është një nderim që i jepet kësaj lirie, të cilës i është ofruar zgjedhja e një rruge, që vetë jo besimtarët e çmojnë fisnike dhe të lavdërueshme. A është, pra, krim kundër lirisë së tjetrit të shpallësh me gëzim një Lajm të Mirë, që e kemi marrë për mëshirë të Zotit? (132) E përse vetëm gënjeshtria dhe gabimi, degjenerimi dhe pornografia e paskan të drejtën që të propozohen dhe shpesh, për fat të keq, të imponohen nga propaganda shkatërruese e *medias masive*, nga toleranca e ligjeve, nga droja e të mirëve dhe nga guximi i të këqijve? Kjo mënyrë e respektueshme e propozimit të Krishtit dhe të Mbretërisë së tij, më shumë sesa një e drejtë, është një detyrë e ungjillzuesit. Dhe është njësoj një e drejtë e njerëzve, vëllezërve të tij, që ta marrin prej tij shpalljen e Lajmit të Mirë të shpëtimit. Këtë shpëtim Hyji mund ta përmbushë në atë që ai do me anë të rrugëve të jashtëzakonshme që vetëm Ai i njej (133). Përveç kësaj, nëse Biri i Hyjit ka ardhur, kjo ka ndodhur pikërisht për të na zbuluar, me anë të fjalës dhe jetës së tij, shtigjet e zakonshme të shpëtimit. Dhe na ka urdhëruar që t'ua përçojmë të tjerëve këtë zbulesë me vetë autoritetin e tij. Nuk do të jetë e kotë që secili i krishterë dhe çdo ungjillzues ta thellojë në lutje këtë mendim: njerëzit do të mund të shpëtohen edhe përmes rrugëve të tjera, falë mëshirës së Hyjit, kur ne nuk ua shpallim atyre Ungjillin; por a do të mund të shpëtojmë ne nëse, për neglizhencë, për frikë, për turp – atë që Shën Pali e quante «turp prej Ungjillit» (134) – apo për rrjedhojë të ideve të rrejshme, e lëmë pa e shpallur? Sepse kjo atëherë do të ishte tradhti ndaj thirrjes së Hyjit që, me anë të gojës së mbarështuesve të Ungjillit, do që të mbijë fara e mbjellë; do të varet prej nesh që kjo të bëhet një pemë dhe që ta japë krejt frytin e vet.

Ta ruajmë, pra, zellin e shpirtit. Ta ruajmë gëzimin e ëmbël dhe ngushëllues për të ungjillzuar, edhe atëherë kur duhet të mbillet në lot. Le të jetë kjo për ne – sikurse që edhe për Shën Gjon Pagëzuesin, për Shën Pjetrin dhe Shën Palin, për Apostujt e tjerë, për një shumicë ungjillzuesish të jashtëzakonshëm përgjatë rrjedhës së historisë së Kishës – një hov i brendshëm, që askush dhe asgjë nuk mund ta fikë. Le të jetë ky gëzimi i madh i jetëve tona të angazhuara. Le të mund ta marrë bota e kohës sonë, që kërkon herë në ankth e herë në shpresë, Lajmin e Mirë jo prej ungjillzuesish të trishtuar dhe të shkurajuar, të padurueshëm dhe në ankth, por prej mbarështuesish të Ungjillit, jeta e të cilëve rrezaton zell që ata vetë e kenë marrë më parë në vetë gëzimin e Krishtit dhe që pranojnë të vihet në lojë vetë jeta e tyre, në mënyrë që Mbretëria të shpallet dhe që Kisha të rrënjohet në zemër të botës.

Përfundimi

DETYRA E VITIT TË SHENJTË

81. Ja, pra, Vëllezër dhe Bij, britma që ngrihet prej thellësisë së zemrës tonë, në jehonë të zërit të Vëllezërve tanë të mbledhur për Asamblenë e tretë të Përgjithshme të Sinodit të Ipeshkvijve. Ja detyra që kemi dashur ta japim në fundin e një Viti të Shenjtë, që na ka mundësuar ta perceptojmë më shumë se kurrë domosdoshmërinë dhe thirrjet e një shumice vëllezërish, të krishterë dhe jo të krishterë, që presin prej Kishës Fjalën e shpëtimit. Drita e Vitit të Shenjtë, që është lartësuar në Kishat vendase dhe në Romë për miliona ndërgjegje të pajtuara me Hyjin, rrezatoftë në të njëjtën mënyrë pas Jubileut me anë të një programi të veprimit baritor, për të cilin ungjillëzimi është aspekti i tij themelor gjatë këtyre viteve që shënojnë vigjiljen e një shekulli të ri, vigjiljen edhe të mijëvjeçarit të tretë të krishterimit.

MARIA, YLLI I UNGJILLËZIMIT

82. Kjo është dëshira që me gëzim e vendosim në duart dhe në zemrën e të Shenjtërueshmes Mari Virgjër të Papërlyer, në këtë ditë që i kushtohet në mënyrë të veçantë asaj, në përvjetorin e dhjetë të mbylljes së Koncilit II të Vatikanit. Në mëngjesin e Rrëshajëve, ajo ka udhëhequr me lutjen e saj fillimin e ungjillëzimit nën veprimin e Shpirtit Shenjt: qoftë ajo Ylli i ungjillëzimit gjithmonë të ripërtërirë që Kisha, e nënshtruar porosisë së Zotërisë së saj, duhet ta përnxisë dhe ta përmbushë, sidomos në këto kohë të vështira, por të mbushura me shpresë! Në emër të Krishtit, ju bekojmë juve, bashkësitë tuaja, familjet tuaja, të gjithë ata që i keni për zemër, me fjalët që Shën Pali ua drejtonte Filipianëve: «Gjithmonë, sa herë më bie ndër mend për ju, falënderoj Hyjin tim. Gjithherë e në çdo lutje që bëj, lutem me gëzim për ju të gjithë për arsye të pjesëmarrjes tuaj në përhapjen e Ungjillit ... Për të vërtetë, unë ju mbaj në zemrën time, sepse ju të gjithë jeni pjesëtarët e hirit tim, ... në mbrojtjen e në përforcimin e Ungjillit. Po, Hyjin e kam dëshmitar se ju dua pa masë të gjithëve me dashurinë e Jezu Krishtit!» (135).

Dhënë në Romë, pranë Shën Pjetrit, më 8 dhjetor, në Solemnitetin e Zojës së Papërlyer, të vitit 1975, i trembëdhjeti vit i Pontifikatit tonë.

Pali PP. VI

- (1) Krh. *Lk* 22,32.
- (2) 2 *Kor* 11,28.
- (3) Krh. *Ad Gentes*, 1: AAS 58, 1966, fq. 947.
- (4) Krh. *Ef* 4,24; 2,15; *Kol* 3,10; *Gal.* 3,27; *Rom* 13,14; 2 *Kor* 5,17.
- (5) 2 *Kor* 5,20.
- (6) Krh. PAPA PALI VI, Fjala e mbylljes së asamblesë së tretë të përgjithshme të Sinodit të Ipeshkvijve (26 tetor 1974): AAS 66, 1974, fq. 634-635; 637.
- (7) PAPA PALI VI, Fjalim para Kolegjit të Shenjtë të Kardinalëve (22 qershor 1973): AAS 65, 1973, fq. 383.
- (8) 2 *Kor* 11,28.
- (9) 1 *Tim* 5,17.
- (10) 2 *Tim* 2,15.
- (11) Krh. 1 *Kor* 2,5.
- (12) *Lk* 4,43.
- (13) *Ibid.*
- (14) *Lk* 4,18; Krh. *Is* 61,1.
- (15) Krh. *Mk* 1,1; *Rom* 1,1-3.
- (16) Krh. *Mt* 6,33.
- (17) Krh. *Mt* 5,3-12.
- (18) Krh. *Ibid.* 5-7.
- (19) Krh. *Ibid.* 10.
- (20) Krh. *Ibid.* 13.
- (21) Krh. *Ibid.* 18.
- (22) Krh. *Ibid.* 24-25.
- (23) Krh. *Ibid.* 24,36; *Vap* 1,7; 1 *Sel* 5,1-2.

- (24) Krh. *Mt* 11,12; *Lk* 16,16.
- (25) Krh. *Mt* 4,17.
- (26) *Mk* 1,27.
- (27) *Lk* 4,22.
- (28) *Gjn* 7,46.
- (29) *Lk* 4,43.
- (30) *Gjn* 11,52.
- (31) Krh. *Dei Verbum*, 4: AAS 58, 1966, fq. 818-819.
- (32) Krh. 1 *Pjt* 2,9.
- (33) Krh. *Vap* 2,11.
- (34) *Lk* 4,43.
- (35) 1 *Kor* 9,16.
- (36) Krh. *Dichiarazioni dei Padri Sinodali*, 4: *L'Osservatore Romano*, 27 tetor 1974, fq. 6.
- (37) *Mt* 28,19.
- (38) *Vap* 2,41.47.
- (39) Krh. *Lumen Gentium*, 8: AAS 57, 1965, fq. 11; *Ad Gentes*, 5: AAS 58, 1966, fq. 951-952.
- (40) Krh. *Vap* 2,42-46; 4,32-35; 5,12-16.
- (41) Krh. *Ibid.* 2,11; 1 *Pjt* 2,9.
- (42) Krh. *Ad Gentes*, 5, 11, 12: AAS 58, 1966, fq. 951-952, 959-961.
- (43) Krh. 2 *Kor* 4,5; Shën Augustini *Sermo XLVI, De Pastoribus*: CCL XLI, fq. 529-530.
- (44) *Lk* 10,16; Krh. Shën Cipriani *De Unitate Ecclesiae*, 14: PL 4, 527; Shën Augustini *Enarrat. 88, sermo 2*, 14: PL 37, 1140; Shën Gjon Gojarti *Hom. de capto Eutropio*, 6: fq. 52, 402.
- (45) *Ef* 5,25.
- (46) *Zb* 21,5; Krh. 2 *Kor* 5,17; *Gal* 6,15.
- (47) Krh. *Rom* 6,4.

- (48) Krh. *Ef* 4,23-24; *Kol* 3,9-10.
- (49) Krh. *Rom* 1,16; 1 *Kor* 1,18; 2,4.
- (50) Krh. *Gaudium et Spes*, 53: *AAS* 58, 1966, fq. 1075.
- (51) Krh. Tertuliani *Apologeticum*, 39: *CCL* 1, fq. 150.153; Minuci Feliks *Octavius*, 9 dhe 31: CSLP, Augustae Taurinorum 1963, fq. 11.13, 47.48.
- (52) 1 *Pjt* 3,15.
- (53) Krh. *Lumen Gentium*, 1, 9, 48: *AAS* 57, 1965, fq. 5, 12-14, 53-54; *Gaudium et Spes*, 42, 45: *AAS* 58, 1966, fq. 1060-1061, 1065-1066; *Ad Gentes*, 1, 5: *AAS* 58, 1966, fq. 947, 951-952.
- (54) Krh. *Rom* 1,16; 1 *Kor* 1,18.
- (55) Krh. *Vap* 17,22-23.
- (56) 1 *Gjn* 3,1; Krh. *Rom* 8,14-17.
- (57) Krh. *Ef* 2, 8; *Rom* 1,16; SACRAE CONGREGATIONIS PRO DOCTRINA FIDEI *Declaratio ad fidem tuendam in mysteria Incarnationis et SS. Trinitatis a quibusdam recentibus erroribus* (21 shkurt 1972): *AAS* 64, 1972, fq. 237-241.
- (58) Krh. 1 *Gjn* 3,2; *Rom* 8,29; *Fil* 3,20-21 dhe *Lumen Gentium*, 48-51: *AAS* 57, 1965, fq. 53-58.
- (59) Krh. SACRAE CONGREGATIONIS PRO DOCTRINA FIDEI *Declaratio circa Catholicam Doctrinam de Ecclesia contra nonnullos errores hodiernos tuendam* (24 qershor 1973): *AAS* 65, 1973, fq. 396-408.
- (60) Krh. *Gaudium et Spes*, 47-52: *AAS* 58, 1966, fq. 1067-1074; PAPA PALI VI *Humanae vitae*: *AAS* 60, 1968, fq. 481-503.
- (61) PAPA PALI VI, Fjalimi i hapjes së asamblesë së tretë të përgjithshme të Sinodit të Ipeshkvijve (27 shtator 1974): *AAS* 66, 1974, fq. 562.
- (62) PAPA PALI VI, Fjalimi i hapjes së asamblesë së tretë të përgjithshme të Sinodit të Ipeshkvijve (27 shtator 1974): *AAS* 66, 1974, fq. 562.
- (63) PAPA PALI VI, Fjalimi para “Fshatarëve” të Kolumbisë (23 gusht 1968): *AAS* 60, 1968, fq. 623.
- (64) IDEM, Fjalimi për “Ditën e zhvillimit” në Bogota (23 gusht 1968): *AAS* 60, 1968, fq. 627; Krh. S. AGOSTINO, *Epistola* 229, 2: *PL* 33, 1020.
- (65) IDEM, Fjalimi i mbylljes së asamblesë së tretë të përgjithshme të Sinodit të Ipeshkvijve (26 tetor 1974): *AAS* 66, 1974, fq. 637.
- (66) PAPA PALI VI, Fjalimi i 15 tetorit 1975: *L'Osservatore Romano*, 17 tetor 1975.

- (67) PAPA PALI VI, Fjalimi para Anëtarëve të «Këshillit të Laikëve» (2 tetor 1974): *AAS* 66, 1974, fq. 568.
- (68) Krh. 1 *Pjt.* 3,1.
- (69) *Rom* 10,14.17.
- (70) Krh. 1 *Kor* 2,1-5.
- (71) *Rom* 10,17.
- (72) Krh. *Mt* 10,27; *Lk* 12,3.
- (73) *Mk* 16,15.
- (74) Krh. Shën Justini *I Apologia*, 46,1-4; *II Apologia*, 7 (8),1-4; 10,1-3; 13,3-4: *Florilegium Patristicum* II, Bonn 1911-2, fq. 81, 125, 129, 133; Klementi i Aleksandrisë *Stremata* 1, 19, 91, 94: *S. Ch.* 30, fq. 117-118, 119-120; *Ad Gentes*, 11: *AAS* 58, 1966, fq. 960; *Lumen Gentium*, 17: *AAS* 57, 1965, fq. 21.
- (75) Eusebi i Çezaresë *Praeparatio Evangelica*, 1, 1: *PG* 21, 26-28; Krh. *Lumen Gentium*, 16: *AAS* 57, 1965, fq. 20.
- (76) Krh. *Ef* 3,8.
- (77) Henri de Lubac, *Le drame de l'humanisme athée*, Ed. Spes, Paris 1945.
- (78) Krh. *Gaudium et Spes*, 59: *AAS* 58, 1966, fq. 1080.
- (79) 1 *Tim* 2,4.
- (80) *Mt* 9,36; 15,32.
- (81) *Rom* 10,15.
- (82) *Dignitatis Humanae*, 13: *AAS* 58, 1966, 939; Krh. *Lumen Gentium*, 5: *AAS* 57, 1965, fq. 7-8; *Ad Gentes*, 1: *AAS* 58, 1966, fq. 947.
- (83) Krh. *Ad Gentes*, 35: *AAS* 58, 1966, fq. 983.
- (84) Shën Augustini *Enarrat. in Ps. 44*, 23: *CCL XXXVIII*, fq. 510; Krh. *Ad Gentes*, 1: *AAS* 58, 1966, fq. 947.
- (85) Shën Gregori i Madh *Homil. in Evangelia*, 19, 1: *PL* 76, 1154.
- (86) *Vap* 1, 8; Krh. *Didachè*, 9, 1: *FUNK, Patres Apostolici*, 1, 22.
- (87) *Mt* 28,20.
- (88) Krh. *Ibid.* 13,32.

- (89) Krh. *Ibid.* 47.
- (90) Krh. *Gjn* 21,11.
- (91) Krh. *Ibid.* 10,1-16.
- (92) Krh. *Sacrosanctum Concilium*, 37-38: *AAS* 56, 1964, fq. 110; Krh. Edhe librat liturgjikë dhe Dokumentet e tjera që kanë dalë në vijim nga Selia e Shenjtë për zbatimin e reformës liturgjike të dëshiruar prej të njëjtin Koncil.
- (93) PAPA PALI VI, Fjalimi i mbylljes së asamblesë së tretë të përgjithshme të Sinodit të Ipeshkvijve (26 tetor 1974): *AAS* 66, 1974, fq. 636.
- (94) Krh. *Gjn* 15,16; *Mk* 3,13-19; *Lk* 6,13-16.
- (95) Krh. *Vap* 1,21-22.
- (96) Krh. *Mk* 3,14.
- (97) Krh. *Ibid.* 3,15; *Lk* 9,2.
- (98) *Vap* 4,8; Krh. *Ibid.* 2,14; 3,12.
- (99) Krh. Shën Leoni i Madh *Sermo* 69,3; *Sermo* 70,1-3; *Sermo* 94,3; *Sermo* 95,2: *S. Ch.* 200, fq. 50-52; 58-66; 258-260; 268.
- (100) Krh. CONC. OECUM. LUGDUNENSIS I *Ad apostolicae dignitatis: Conciliorum Oecumenicorum Decreta*, Ed. Istituto per le Scienze Religiose, Bologna 1973, p. 278; CONC. OECUM. VIENNENSIS *Ad providam Christi*, ed. mem., fq. 343; CONC. OECUM. LATERANENSIS V *In apostolici culminis*, ed. mem., fq. 608; *Postquam ad universalis*, ed. mem., fq. 609; *Supernae dispositionis*, ed. mem., fq. 614; *Divina disponente clementia*, ed. mem., fq. 638.
- (101) *Ad Gentes*, 38: *AAS* 58, 1966, fq. 985.
- (102) Krh. *Lumen Gentium*, 22: *AAS* 57, 1965, fq. 26.
- (103) *Lumen Gentium*, 10, 37: *AAS* 57, 1965, fq. 14, 43; *Ad Gentes*, 39: *AAS* 58, 1966, fq. 986; *Presbyterorum Ordinis*, 2, 12, 13: *AAS* 58, 1966, fq. 992, 1010, 1011.
- (104) Krh. 1 *Sel* 2,9.
- (105) Krh. 1 *Pjt* 5,4.
- (106) *Lumen Gentium*, 11: *AAS* 57, 1965, fq. 16; *Apostolicam Actuositatem*, 11: *AAS* 58, 1966, fq. 848; Shën Gjon Gojarti *In Genesim Serm.* VI, 2; VII, 1: fq. 54, 607-608.
- (107) *Mt* 3,17.

- (108) *Ibid.* 4,1.
- (109) *Lk* 4,14.
- (110) *Lk* 4,18.21; *Krh. Is* 61,1.
- (111) *Gjn* 20,22.
- (112) *Vap* 2,17.
- (113) *Krh. Ibid.* 4,8.
- (114) *Krh. Ibid.* 9,17.
- (115) *Krh. Ibid.* 6,5.10; 7,55.
- (116) *Krh. Ibid.* 10,44.
- (117) *Krh. Ibid.* 9,31.
- (118) *Krh. Ad Gentes*, 4: *AAS* 58, 1966, fq. 950-951.
- (119) *Gjn* 17,21.
- (120) *Krh. Vap* 20,28.
- (121) *Krh. Presbyterorum Ordinis*, 13: *AAS* 58, 1966, fq. 1011.
- (122) *Krh. Heb* 11,27.
- (123) *Ad Gentes*, 6: *AAS* 58, 1966, 954-955; *Krh. Unitatis Redintegratio*, 1: *AAS* 57, 1965, fq. 90-91.
- (124) *Apostolorum Limina*, VII: *AAS* 66, 1974, fq. 305.
- (125) *Rom* 5,5.
- (126) *Krh. Gjv* 8,32.
- (127) *1 Sel* 2,8; *Krh. Fil* 1,8.
- (128) *Krh. 1 Sel* 2,7.11; *1 Kor* 4,15; *Gal* 4,19.
- (129) *Krh. 1 Kor* 8,9-13; *Rom* 14,15.
- (130) *Krh. Rom* 12,11.
- (131) *Krh. Dignitatis Humanae*, 4: *AAS* 58, 1966, fq. 933.

(132) *Ibid.* 9-14: *AAS* 58, 1966, fq. 935-940.

(133) *Krh. Ad Gentes*, 7: *AAS* 58, 1966, fq. 955.

(134) *Krh. Rom* 1,16.

(135) *Fil* 1,3-4.7-8.